



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 390 Akti

Nr. 464 Vendimi
Tiranë, më 28.10.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|---------------------------|-----------|
| Genta Tafa (Bungo) | Kryesuese |
| Lulzim Hamitaj | Relator |
| Etleda Çiftja | Anëtare |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në Tiranë, më 25.10.2021, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Klorinda Çela**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisioner Lulzim Hamitaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura prej saj gjatë hetimit administrativ, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, pas zhvillimit të procedurave të shpërndarjes së çështjeve me short në datën 16.12.2019, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Etleda Çiftja dhe Lulzim Hamitaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Lulzim Hamitaj.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 23.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuese Genta Tafa (Bungo), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Klorinda Çela.
5. Bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Klorinda Çela nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Me vendimin nr. 2, datë 3.9.2021, trupi gjykues u mbledh dhe miratoi kërkesën e relatorit të çështjes për të disponuar në lidhje me administrimin dhe përdorimin e disa shkresave dhe kthim përgjigjeve nga dosja e hetimit të subjektit të rivlerësimit, z. K. Dh., të cilat, në formën e kërkuar, iu bashkëlidhën dosjes së hetimit për subjektin e rivlerësimit Klorinda Çela.
8. Në vijim të hapave hetimore, në datën 6.10.2021, me vendimin nr. 3, trupi gjykues, pasi vlerësoi ekzistencën e një niveli të lartë provueshmërie të provave të administruara, vendosi të mbyllë fazën hetimore dhe, në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, çmoi që procesi i rivlerësimit për znj. Klorinda Çela të bazohej vetëm në kriterin e pasurisë.
9. Në datën 6.10.2021 Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 18.10.2021; si

dhe (iii) të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.

10. Më tej, në datën 21.10.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 4, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Klorinda Çela në seancën dëgjimore, datë 22.10.2021, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, sikurse ishte njoftuar paraprakisht në datën 18.10.2021. Në datën 22.10.2021, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike, ka kërkuar caktimin e një date tjetër për seancën dëgjimore, duke qenë se për arsye shëndetësore nuk mund të paraqitej në seancën e caktuar, duke bashkëlidhur edhe raportin mjekësor me nr. regjistri ***.
11. Me vendimin nr. 5, datë 22.10.2021, trupi gjykues vendosi të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shkaqe shëndetësore, duke caktuar seancën dëgjimore në datën 25.10.2021, ora 13:00.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Klorinda Çela, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 25.10.2021, ora 13:00, në ambientet e Pallatit e Koncerteve (ish- Pallati Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit në seancën dëgjimore dhe as nuk ushtroi të drejtën e përfaqësimit.
13. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, duke mos e vlerësuar të provuar të kundërtën e rezultateve që i ishin kaluar barrë prove subjektit, vendosi të konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Klorinda Çela, duke u bazuar vetëm mbi kriterin e rivlerësimit të pasurisë. Seanca dëgjimore e datës 25.10.2021, u mbyll, për të rifilluar më 28.10.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

14. Znj. Klorinda Çela nuk ka qenë gjithmonë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, duke mos iu përgjigjur plotësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha pyetjeve të dërguara gjatë hetimit administrativ, si edhe duke mos depozituar dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

15. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit me Komisionin, të bëra me anë të komunikimit elektronik; si dhe (v) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja

17. Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:
- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - *ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - *ka kryer deklaratim të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
18. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
19. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; si dhe evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

1. Apartament banimi me sip. 114.6 m², Tiranë

20. Kjo pasuri ndodhet në rrugën “D. B.”, Tiranë, me vlerë 74,000 euro, porositur me kontratën e shitjes me rezervë, datë 3.6.2005, dhe blerë me kontratën e shitjes, datë 7.4.2015. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti, në DIPP-në e vitit 2005, ka deklaruar: (i) hua në shumën 52,000 euro, me huadhënës “Tirana Bank”, me afat shlyerjeje 15 vjet dhe detyrim të mbetur 51,000 euro, ndërsa në deklaratën *Vetting*, përveç burimit të sipërpërmendur, ajo ka deklaruar si burim krijimi edhe: (ii) të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit, përkatësisht nga Shkolla e Magjistraturës dhe nga gjykatat përkatëse të ushtrimit të detyrës; (iii) kontrata e huas me shtetasin A. Ç., në masën 2,000,000 lekë; si dhe (iv) të ardhurat nga shitja e librit të bashkëshortit, afërsisht në masën 300,000 lekë.

Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni

21. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në datën 3.6.2005 është lidhur kontrata e shitjes me rezervë¹ mes shoqërisë ndërtuese “E.” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse², dhe subjektit e bashkëshortit të saj, në cilësinë e palës blerëse, për një apartament me sipërfaqe ndërtimi 124 m² në total³, me çmim shitjeje 74,400 euro, me plan pagesash: (i) 22,400 euro me nënshkrimin e kontratës në fjalë; dhe (ii) 52,000 euro me kredi bankare brenda datës 30.7.2005.
22. Nga dokumentacioni i disponuar ka rezultuar se “Tirana Bank”, me vërtetimin e datës 26.10.2016, ka bërë me dije se z. K. Dh. dhe znj. Klorinda Çela kanë pasur një limit kredie për banesë në shumën 52,000 euro, me datë disbursimi 22.8.2005, kredi kjo që është mbyllur

¹Kontrata e shitjes me rezervë me nr. *** prot., e datës 3.6.2005, konfirmuar me dokumentin noterial vërtetim nënshkrimi nr. ***, datë 8.6.2005, nga noteri publik R. S..

²E përfaqësuar nga z. G. D..

³I përbërë nga sip. 114.6 m², sipërfaqe apartamenti dhe 9.4 m² sipërfaqe në pjesën e përbashkët të shkallës.

në datën 13.1.2012⁴. Bashkëlidhur kontratës së shitjes me rezervë ndodhen lëvizjet e dy llogarive bankare të shoqërisë ndërtuese “E.” sh.p.k., me anë të të cilave kanë rezultuar dy transfertat bankare: (i) shuma 2,770,000 lekë e kryer nga subjekti i rivlerësimit në datën 3.6.2005, me përshkrimin “TRN from Klorinda Çela, ‘lik. 30% blerje shtëpie (22,400 euro)’”; dhe (ii) shuma 52,000 euro e kryer nga bashkëshorti i subjektit në datën 23.8.2005, me përshkrimin “TRN from K. Dh., likuidim apartamenti”. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2005 ka rezultuar se subjekti nuk ka deklaruar kryerjen e pagesës së shumës prej 2,770,000 lekësh dhe as burimin e krijimit të saj.

23. Në vijim, në datën 7.4.2015 është lidhur kontrata e shitjes⁵ midis shoqërisë shitëse “E.” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit e bashkëshortit të saj⁶, në të cilën është deklaruar se blerësi ka paguar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes 74,400 euro, sipas kontratës së shitjes me rezervë të datës 3.6.2005⁷.
24. Subjekti, pasi është pyetur nga Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, është shprehur se: *“Është tërësisht i pasaktë nga ana juaj mosdeklarimi i pagesës prej 30% në favor të shoqërisë ‘E., jo vetëm në deklarimet periodike vjetore, por edhe në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, pas kallëzimit me karakter tërësisht politik dhe diskriminues të bërë nga ky institucion ndaj meje dhe bashkëshortit tim, është shpjeguar burimi i kësaj pagese, si dhe është deklaruar pagimi i saj. Ju vë në vëmendje që marrja e një kredie në atë kohë automatikisht kërkonte pagimin nga kredimarrësi të shumës prej 30% të vlerës së pasurisë, përndryshe kredia nuk miratohej”*.
25. Komisioni ka konstatuar se në deklaratën *Vetting* subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me vlerën/çmimin e blerjes së kësaj pasurie, pasi edhe nga dokumentacioni në dosje, pagesa për blerjen e pasurisë është kryer në dy këste në favor të të shoqërisë “E.” sh.p.k., si vijon: (i) në datën 3.6.2005, nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në “Tirana Bank” është transferuar shuma 2,770,000 lekë; dhe (ii) në datën 23.8.2005, nga llogaria e kredisë së hapur në emër të saj në “Tirana Bank” është transferuar shuma prej 52,000 euro. Subjekti, e pyetur nga Komisioni lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e kësaj të parë, deklaroi si burim krijimi: (i) pagën e saj dhe të bashkëshortit në Shkollën e Magjistraturës; (ii) pagën e saj dhe të bashkëshortit si gjyqtarë; si dhe (iii) huan e dhënë nga shtetasi A. Ç..
26. Komisioni verifikoi DIPP-të e depozituara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, ndër vite, në ILDKPKI, nga ku rezultoi se: (i) në deklaratën fillestare të pasurisë, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar pasuri në formë likuiditetesh; (ii) një depozitë në të holla në shumën 850,000 lekë, viti i krijimit 2004, si dhe një depozitë në të holla, të bashkëshortit të saj, në shumën 650,000 lekë.
27. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni iu drejtua subjektit duke i kërkuar të bënte me dije lidhur me burimin e krijimit të depozitave në fjalë, në përgjigje të së cilës, është shprehur se: *“Lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume mua dhe bashkëshortit tim i është bërë hetim nga ana e ILDKPKI-së, ku dhe janë dhënë sqarime, madje është mbajtur edhe procesverbal deklarimi. Gjithashtu dhe në deklarimin periodik vjetor është treguar burimi i të ardhurave. Rezultatet e hetimit i gjeni tek ILDKPKI-ja, pasi ata nuk na kanë vënë në dispozicion kopje të rezultateve të hetimit siç bëjnë me çdo deklarames”*.

⁴Me anë të deklaratës për lirim prone nr. ***, datë 27.3.2015, “Tirana Bank” ka liruar nga barra hipotekore kolateralët e ofruar për sigurimin e kësaj kredie.

⁵Kontratë shitjeje me nr. ***, datë 7.4.2015.

⁶Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti janë të përfaqësuar në këtë kontratë me prokurë të posaçme nga shtetasi A. Ç..

⁷ZQPPP-ja Tiranë, me shkresat nr. *** prot., datë 24.4.2018 dhe nr. *** prot., datë 18.4.2018, kanë konfirmuar regjistrimin e pasurisë në fjalë.

28. Lidhur me burimin e krijimit të deklaruar nga subjekti ka rezultuar se nga verifikimi i dokumentacionit bankar të “Tirana Bank” ka rezultuar se gjendja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit në datën 31.12.2004 ka qenë 62,762 lekë, ndërsa gjendja e llogarisë së personit të lidhur në datën 31.12.2004, ka qenë në vlerën 845,974 lekë.
29. Në vijim, Komisioni ka verifikuar dhe ka kryer një analizë të detajuar të llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në “Tirana Bank”, nga ku ka rezultuar se gjendja e llogarisë në datën 31.12.2004 është krijuar nga depozitimet e bëra gjatë vitit 2004 (+ interesat), si vijon: (i) në datën 16.3.2004, personi i lidhur ka depozituar shumën prej 410,000 lekësh; (ii) në datën 15.7.2004, personi i lidhur ka depozituar shumën 350,000 lekë; dhe (iii) në datën 30.8.2004, subjekti ka depozituar shumën 650,000 lekë dhe, në total, shuma e depozituar deri në këtë datë rezulton në vlerën 1,410,000 lekë.
30. Komisioni konstaton se vetëm subjekti i rivlerësimit ka pasur gjendje në llogaritë në “Tirana Bank” në datën 31.12.2003, në shumën 62,762 lekë dhe nuk rezulton të kenë pasur llogari të hapura në banka të tjerë për këtë periudhë. Nisur nga mosdeklarimi i gjendjes *cash* dhe burimit të krijimit të llogarive bankare, Komisioni vlerëson se krahas shumës së mësipërme si burim krijimi për depozitimet në bankë në vitin 2004, mund të kenë shërbyer vetëm të ardhurat e krijuara gjatë këtij viti.
31. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për harkun kohor 1.1.2004 – 30.8.2004, të pasqyruar në tabelën vijuese.

Tabela nr. 1

| Analiza financiare për periudhën 1.1.2004 – 30.8.2004 | Vlerat në lekë |
|---|-----------------|
| Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit | 345 150 |
| Të ardhura nga paga, bashkëshorti i subjektit | 441 526 |
| Ndryshim likuiditeti | -1 433 139 |
| Shpenzime jetike | -164 262 |
| Rezultati | -810 725 |

32. Nga sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve të depozituara në “Tirana Bank” gjatë vitit 2004, në masën 810,725 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

33. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ për këtë pasuri, në prapësimet e dërguara ka pretenduar se nuk ka mospërputhje midis burimeve të ligjshme të pasurisë pasi 70% e saj është një kredi, që është paguar brenda 7 vjetëve, të cilët janë pasqyruar në DIPP-në e vitit 2005, si dhe në deklaratën *Vetting*, në të cilën përfshinte si burime të ligjshme të kësaj pasurie edhe burime të tjera nga viti 2005 e deri në pagimin e plotë të kësaj kredie. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se ka qenë studente në Shkollën e Magjistraturës prej vitit 2003, ndërsa bashkëshorti K. Dh. prej vitit 2001 dhe se të ardhurat e tyre nuk janë vetëm ato të fituara gjatë vitit 2004, por edhe në vitet e mëparshme.
34. Lidhur me analizën financiare të burimeve për krijimin e kursimeve, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare, duke pretenduar se është analizuar vetëm harku kohor 1.1.2004 – 30.8.2004, pa asnjë shpjegim, pasi këto kursime nuk bazohen vetëm tek të ardhurat nga paga e tyre, pasi gjatë kësaj periudhe janë ndihmuar edhe nga prindërit e tyre dhe, për rrjedhojë,

rezultati financiar është i mangët, pasi në të duhet të përfshinte edhe periudhën paraardhëse që përkon me vitet 2001 – 2003.

Vlerësimi i trupit gjykues

35. Trupi gjykues, pasi ka analizuar të gjitha dokumentet e administruara, duke mbajtur në vëmendje edhe shpjegimet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se familja e këtij të fundit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve të depozituara në “Tirana Bank”, gjatë vitit 2004. Lidhur me pretendimin se e konsideron të pabazuar kryerjen e analizës financiare vetëm për harkun kohor 1.1.2004 – 30.8.2004, Komisioni arrin në përfundimin se vetëm subjekti i rivlerësimit ka pasur gjendje në llogaritë në “Tirana Bank” në datën 31.12.2003, në shumën 62,762 lekë dhe se nuk ka rezultuar që ajo apo bashkëshorti i saj të kenë pasur llogari të hapura në banka të tjera për këtë periudhë. Për rrjedhojë, duke konsideruar edhe faktin e mungesës së gjendjes cash, që mund të ishte përdorur, arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.
36. Për sa më sipër, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 810.725 lekësh për të krijuar likuiditetet e depozituara në “Tirana Bank” gjatë vitit 2004.

Huaja nga shtetasi A. Ç.

37. Përveç sa më sipër është përshkruar si burim krijimi në deklaratën *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, subjekti ka deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë një hua të marrë nga shtetasi A. Ç., në shumën 2,000,000 lekë. Për të provuar sa më sipër, vuri në dispozicion kontratë huaje të datës 22.7.2005 të konfirmuar para noterit në datën 9.6.2006 dhe të rikonfirmuar me një deklaratë noteriale nr. ***, datë 29.10.2016, të nënshkruara ndërmjet shtetasit A. Ç. dhe bashkëshortit të subjektit, për huan në shumën 2,000,000 lekë, me afat 5-vjeçar me interes 5%/vit, hua e cila do të shlyhet me këste.
38. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2005, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar në seksionin “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, huan në shumën 2,000,000 lekë me huadhënësin A. Ç.⁸ dhe se në vitet 2006, 2007 dhe 2008 subjekti dhe bashkëshorti deklarojnë huan si të pashlyer dhe si detyrim të mbetur ndaj shtetasit A. Ç., shumën 2,000,000 lekë. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2017 ka rezultuar se subjekti ka deklaruar detyrimin financiar ndaj shtetasit A. Ç., si një detyrim ende të pashlyer, në DIPP-në e vitit 2018 ka deklaruar se është shlyer shuma 800,000 lekë dhe detyrimi i mbetur në vlerën 1,200,000 lekë, ndërsa në DIPP-në e vitit 2019, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi të dhëna lidhur me këtë hua⁹.
39. Nga dokumentacioni i disponuar, deklaratë noteriale¹⁰ e datës 29.10.2016, huadhënësi A. Ç. ka deklaruar se: “[...] i kam dhënë hua z. K. Dh. shumën prej 2,000,000 lekësh, kjo shumë është përfutur prej punës disavjeçare të bërë prej meje në shtetin grek. Nga huaja e dhënë nuk më është paguar asnjë këst, fakt ky që e kam toleruar për shkak të marrëdhënieve miqësore që kam me z. K. Dh.. Dhënia e huas nuk është realizuar me mandat bankar, por është dhënë cash në dorë [...]”.
40. Lidhur me sa më sipër, nëpërmjet pyetësorit nr. 1, Komisioni i ka kërkuar subjektit të deklarojë mbi huat, shumën e marrë, datën, marrëdhënien me huadhënësin, kushtet e

⁸Ndërkohë që në DIPP-në e vitit 2005 të bashkëshortit është deklaruar një kontratë huaje me përshkrimin “kontratë huaje shuma 2,000,000 lekë. Fillimi i kontratës datë 20.6.2005, përfundimi i kontratës datë 20.6.2010, interes 5%/vit, huadhënësi A. Ç.”.

⁹Deklaratat periodike vjetore të viteve 2018 dhe 2019, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 8.9.2021, të ILDKPKI-së.

¹⁰Deklarata noteriale me nr. ***, datë 29.10.2016, redaktuar nga noteri publik, znj. R. R..

shlyerjes dhe gjendjen e shlyerjes, të depozitonte dokumentacionin provues lidhur me marrëdhëniet e mundshme të huas, si dhe dokumentacionin ligjor që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit.

41. Në përgjigje¹¹ të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar huan e marrë nga bashkëshorti shtetasit A. Ç., në datën 22.7.2005, në shumën 2,000,000 lekë, duke deklaruar se kjo hua është shlyer pjesërisht në shumën 800,000 lekë dhe se detyrimi i mbetur është në masën 1,200,000 lekë. Lidhur me marrëdhënien me shtetasin A. Ç. ka deklaruar se ka qenë miku më i ngushtë i bashkëshortit të saj dhe se në kohën e dhënies së huas ai ka qenë punonjës në “Raiffeisen Bank” dhe se, gjithashtu, ai ka qenë shumë vite në emigracion. Më tej, ka deklaruar se nuk ka mundësi të bëjë me dije burimin e krijimit të këtyre të ardhurave nga huadhënësi dhe se ky i fundit për këtë ka dhënë shpjegime edhe në prokurori.
42. Subjekti, e pyetur nga Komisioni lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të huas, në përgjigje të pyetjes nr. 15, në pyetësorin nr. 2, ka sqaruar se: *“Lidhur me huan e marrë nga shtetasi A. Ç. ne kemi bërë gjithë deklaratimet e nevojshme në deklarin periodik vjetor dhe në deklaratën Vetting, ku kemi paraqitur të gjitha provat shkresore që vërtetojnë këtë hua. Ne kemi kthyer 800,000 lekë dhe kjo është bërë nëpërmjet ‘Raiffeisen Bank’. Nuk kemi paguar interes deri tani pasi, miqësisht është lënë të paguhet një herë e gjithë shuma. Burimi i të ardhurave të shumës së paguar është përcaktuar në deklarin periodik vjetor”*. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëlidhur ndonjë dokumentacion ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit A. Ç..
43. Referuar dokumentacionit të disponuar, Komisioni ka konstatuar se në bazë të kontratës¹² së datës 16.7.2015, person fizik “A. Ç.” ka marrë me qira nga subjekti dhe bashkëshorti i saj ambientin e llojit njësi shërbimi me sip. 44 m², kundrejt shumës prej 172,500 lekësh¹³. Ndërsa, nëpërmjet vërtetimit¹⁴ të datës 30.12.2016, z. A. Ç., në cilësinë e përfaqësuesit të personit fizik, “A. Ç.”, ka deklaruar: *“Gjatë kohëzgjatjes së qirasë për ambientin me sip. 44 m², në rrugën ‘H. D.’, Tiranë, me vlerë totale mujore qiraje 172,500 lekë/muaj, është paguar në mënyrë të rregullt qiraja në masën 146,625 lekë/muaj ose në masën 2,932,500 lekë deri në datën 31.12.2016”*.
44. Nisur nga sa më sipër është cituar, Komisioni i kërkoi subjektit të qartësojë këtë marrëdhënie¹⁵ dhe, konkretisht, të shpjegonte lidhur me faktin se nga njëra anë për një periudhë të gjatë kohore subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë shlyer huan e marrë nga shtetasi A. Ç., ndërsa nga ana tjetër ky i fundit i ka paguar qira për dyqanin deri në datën 31.12.2016, në vlerën 2,932,500 lekë. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se shtetasi A. Ç. ka rënë dakord me mospagimin, pasi kanë pasur prioritete të tjera dhe se pasi të realizohet pagesa e gjithë huas, dhe do të marrë përqindjen e interesit për këtë.
45. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se për pagesa e kështit të parë për apartamentin objekt vlerësimi është kryer në datën 3.6.2005, ndërkohë që kontrata e huas mban datën 22.7.2005, si dhe po ashtu në DIPP-në e vitit 2005, bashkëshorti i subjektit ka vetëdeklaruar datën 20.6.2005, si datë fillimi të kontratës së huas, për rrjedhojë, huaja e

¹¹Pyetja nr. 2 e pyetësorit nr. 2.

¹²Kontrata e qirasë nr. ***, datë 16.7.2015 (pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, Aneks 4/10).

¹³Afati i kontratës së qirasë është përcaktuar 5 vjet, afat që ka filluar në datën 1.5.2015. Megjithëse kontrata e qirasë është nënshkruar në datën 16.7.2015 – dhe në të referohet fakti se afati i qirasë ka filluar në datën 1.5.2015, Komisioni konstaton se subjekti “A. Ç.”, person fizik, me NIPT ***, e ka regjistruar në QKB si adresë sekondare dyqanin e marrë me qira – në datën 11.11.2015.

¹⁴Pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, Aneks 4/10.

¹⁵Pyetja nr. 9.1, e pyetësorit nr. 2.

deklaruar nuk mund të kishte shërbyer si burim krijimi për pagesën e kryer më herët nga subjekti dhe bashkëshorti.

46. Nga sa më sipër, konstatohet se e gjitha marrëdhënia financiare e subjektit të rivlerësimit me shtetasin A. Ç. paraqitet kontradiktore dhe pa logjikë ekonomike dhe, në këtë kontekst, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme lidhur me vërtetësinë e marrëdhënies së huas në masën 2,000,000 lekë dhe marrëdhënies së qirasë me këtë shtetas.
47. Lidhur me burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur A. Ç., Komisioni ka konstatuar se në kushtet kur subjekti nuk dha shpjegime shteruese, si dhe nuk paraqiti asnjë dokumentacion ligjor që të provonte burimin e ligjshëm të krijimit të huas nga huadhënësi, arrin në përfundimin se nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, për të mundësuar dhënien e huas në favor të subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, huaja e pretenduar si e marrë nga shtetasi A. Ç., në shumën 2,000,000 lekë nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për pagesën e këstit të parë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

48. Në vijim të prapësimeve të depozituara, subjekti nuk ka qenë dakord me konkluzionet e arritura nga Komisioni, duke prapësuar se: *“Së pari marrëdhënia financiare midis bashkëshortit K. Dh. dhe shtetasit A. Ç. është një marrëdhënie që nuk bazohet në fitimin, por në ndihmën e ndërsjellë dhe kjo në formën e huas, dhe së dyti: nuk mund të shihet kjo marrëdhënie huaje e shkëputur nga marrëdhënia e ngushtë miqësore, të cilën e kemi të ruajtur edhe sot”*. Lidhur me mospagimin e plotë të huas, subjekti ka prapësuar duke bërë me dije se është bërë me pëlqimin e plotë të huadhënësit dhe se huaja do të paguhet bashkë me interesat në një moment të dytë.
49. Lidhur me marrëdhënien me shtetasin A. Ç. ka shpjeguar se ai ka qenë për vite me radhë në emigracion dhe kjo shumë është siguruar kryesisht nga puna si emigrant në Greqi dhe nga puna në Shqipëri, shtetasi ka mbajtur deklarime para Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku dhe ka dhënë shpjegime lidhur me këtë hua. Shuma prej 2,000,000 lekësh, e marrë hua nuk është një shumë që i është marrë një pensionisti apo një personi që trajtohet me asistencë sociale, por dikujt që ka punuar për shumë vite në emigracion dhe që deri më sot ka bërë punë të ndryshme në sektorin privat me një pagë relativisht të kënaqshme.
50. Konkluzioni i arritur nga Komisioni se huaja nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për pagimin e këstit është një hamendeshim që nuk ka aspak lidhje me atë që ka ndodhur në të vërtetë. Kjo marrëdhënie bazohet në akte të mbajtura para noterit dhe, si të tilla, ato provohen me prova shkresore.

Vlerësimi i trupit gjykues

51. Komisioni çmon të theksojë se si gjatë hetimit administrativ, por edhe pas kalimit të barrës së provës, me dërgimin rezultateve, por edhe nga analiza e rrethanave dhe fakteve të konstatuara më sipër, subjekti i rivlerësimit, përpos shpjegimeve të përgjithshme mbi statusin apo të kaluarën e huadhënësit të pretenduar, nuk ka depozituar asnjë dokumentacion ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit A. Ç. dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të mundësuar dhënien e huas në masën 2,000,000 lekë në favor të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit.

Të ardhura të bashkëshortit nga botimi i librit

52. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si një ndër burimet e përdorura për blerjen e apartamentit edhe të ardhura të bashkëshortit nga shitja e librit “Fjalori i termave të së drejtës, italisht - shqip - italisht”, në shumën përafërsisht 300,000 lekë. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2005, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar të ardhurat e bashkëshortit ndërsa vetë bashkëshorti, në deklarimin e tij të vitit 2005, ka deklaruar të ardhura si autor i librit në shumën 250,000 lekë.
53. Lidhur me këto të ardhura në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, Komisioni i kërkoi subjektit të vinte në dispozicion dokumentacionin ligjor që provonte përfitimin e tyre, por në përgjigje të pyetësorëve subjekti nuk depozitoi asnjë dokumentacion dhe, ndër të tjera, ka deklaruar se nuk disponon fatura për shkak të informalitetit të kohës dhe se lidhur me shitjen e librave tek Libri Universitar nuk zotëron dokumentacion, pasi autorët e librave nuk marrin fatura TVSH-je edhe sot e kësaj dite.
54. Trupi gjykues kreu analizën financiare lidhur mbi mundësinë e krijimit të likuiditeteve gjendje në bankë në vitin 2004 mbi marrëdhënien e huas me shtetasin A. Ç., si dhe mbi të ardhurat e deklaruara si autor libri ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar plotësisht pagesën e kështit të parë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

55. Edhe pas kalimit të barrës së provës subjektit të rivlerësimit për të dhënë argumente/shpjegime dhe apo/prova që të provonin të kundërtën e rezultateve të arritura nga Komisioni në prapësimet e depozituara, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim duke rikonfirmuar se mosparaqitja e dokumentit justifikues është tërësisht e justifikuar, pasi edhe sot shitja e librave nga autorët bëhet joformalisht dhe se shitësit e librave në atë kohë nuk nxirrin kupon tatimor. Në këto kushte, trupi gjykues nuk gjen arsye për të ndryshuar vlerësimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit në fjalë.

Kredia në shumën 52,000 euro, në “Tirana Bank”

56. Në DIPP-në e vitit 2005 dhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekti vlerësimi - kredinë e marrë në “Tirana Bank” me kontratën e datës 22.7.2005, në shumën 52,000 euro, me afat shlyerje 15 vjet. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga “Tirana Bank” konfirmohet se subjekti dhe bashkëshorti kanë lidhur kontratën e huas¹⁶ për shumën 52,000 euro, me objekt kredie “blerje apartamenti¹⁷”. Nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me pagesën e kështit të dytë të apartamentit në analizë, në shumën 52,000 euro, me burim nga kredia e marrë në “Tirana Bank”.
57. Për rrjedhojë, nisur nga sa më lart është arsyetuar, trupi gjykues çmon se rezultatet e kristalizuara në fund të hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, dhe të njoftuara subjektit,

¹⁶Kontratë huaje nr. ***, datë 19.8.2005, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga “Tirana Bank” në ILDKPKI – ndodhur në aneks 4/1.

¹⁷Referuar kontratës së kredisë ka rezultuar se si garanci për shlyerjen e huas/kredisë janë vendosur 4 pasuri të shtetasit A. D., përkatësisht, 3 garazhe dhe 1 apartament, të ndodhur në K., Kavajë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se ajo dhe bashkëshorti nuk kanë njohje me shtetasit A. dhe G. D. dhe se nuk kanë pasur asnjë çështje të gjykuar. Ajo, gjithashtu, sqaron se në kohën kur është lidhur kontrata miku i bashkëshortit, A. Ç. ka punuar menaxher shitjesh pranë kësaj shoqërie. Nga dokumentacioni i disponuar ka rezultuar se në datën 22.8.2005, janë disbursuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit fondet e kredisë në shumën 51,000 euro, të cilat në datën 23.8.2005, ai ka depozituar në këtë llogari shumën 1,510 euro dhe, në vijim, nga kjo llogari po në datën 23.8.2005 është transferuar në favor të shoqërisë “E.sh.p.k. shuma prej 52,000 euro, me përshkrimin “likuidim apartamenti”.

nuk pësojnë ndryshime nga prapësimet e subjektit dhe konfirmohet pamjaftueshmëria financiare e lartpërmendur.

2. Njësi shërbimi me sip. 44 m², në rrugën 'H. D.', Tiranë

58. Pasuria e llojit njësi¹⁸ shërbimi është deklaruar për herë të parë nga subjektit në DIPP-në e vitit 2012, por pa deklaruar vlerë, si pasuri e përfituar nëpërmjet dhurimit nga babai i saj, z. Sh. Ç., ndërkohë, për herë të parë në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se vlera e pronës pas rivlerësimit është 21,000,000 lekë. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar kontratën e dhurimit nr. ***, datë 19.10.2012. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar rezulton se pasuria me tej është shitur me anë të kontratës nr. ***, datë 22.12.2017, znj. Sh. M. kundrejt çmimit 100,000 euro¹⁹. Konstatohet se nuk ka informacion të mëtejshëm lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e paguara, sa i takon diferencës nga çmimi i blerjes së kësaj pasurie nga prindërit e subjektit me çmimin e shitjes më pas nga subjekti dhe bashkëshorti prej 100,000 euro, por edhe nga shqyrtimi *online* në sistemin multifunksional të ASHK-së nuk ka informacion të mëtejshëm lidhur me regjistrimin e pasurisë në emër të palës blerëse²⁰.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

59. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 23.11.2011, është regjistruar në pronësi të z. Sh. Ç., pasuria me nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, me sip. 44 m², në rrugën "H. D.". ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 18.4.20218, ka konfirmuar pasurinë e llojit njësi shërbimi me sip. 44 m², regjistruar me nr. ***, duke vënë në dispozicion edhe kontratën e dhurimit të pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 19.10.2012, midis palës dhuruese Sh. dhe M. Ç. dhe palës pranuese të dhurimit K. Dh. dhe Klorinda Çela.
60. Më pas, pasuria në fjalë është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, me nr. pasurie ***, në z. k. *** dhe në datën 26.11.2013, për të cilën është lëshuar edhe certifikata për vërtetim pronësie, ku në kartelën e pasurisë, në seksionin "përshkrim i veçantë" është shënuar "vlera e tregut të pasurisë sipas çmimeve të vitit 2012 është 21,000,000 lekë".
61. UKT-ja, me shkresën nr. akti *** prot., datë 5.2.2020, ka bërë me dije se në emër të shtetasit K. Dh.²¹, bashkëshorti i subjektit, ekzistojnë tri kontrata, për subjektin e rivlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë, ndërsa për shtetasin V. Dh.²² ekzistojnë tri kontrata. FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2020, ka bërë me dije se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj nuk rezulton të jenë abonentë apo të kenë lidhur kontratë të furnizimit të energjisë elektrike.
62. Nga sa më sipër, Komisioni konstatoi mospërputhje midis numrit të pasurisë së njësisë në analizë në regjistrimin në emër të babait të subjektit dhe, më pas, në regjistrimin në emër të kësaj të fundit, duke i kërkuar shpjegime lidhur me këtë mospërputhje, si dhe duke i kaluar barrën e provës për depozitimin e dokumentacionit ligjor për të provuar të gjitha transaksionet e kryera lidhur me pasurinë e dhuruar.

¹⁸Kjo pasuri është vendosur si kolateral nga subjekti dhe bashkëshorti me kontratën e hipotekës datë 9.5.2016, për të garantuar kthimin e shumës 21,000,000 lekë, të marrë me kontratën e kreditë nr.***, datë 9.5.2016, në SGA Bank.

¹⁹Kontrata e shitjes nr. ***, datë 22.12.2017, konfirmohet edhe nga RNSH-ja, Ministria e Drejtësisë.

²⁰Shtetasja Sh. M. rezulton të ketë në pronësi një apartament të përfituar nga privatizimi, ndodhur në V., Tiranë.

²¹Konkretisht, kontrata me nr. ***, në rrugën "D. B.", kontrata nr. ***, rruga "D. B.", kontrata nr. ***, rruga "D. B.", Tiranë.

²²Konkretisht, kontrata me vendndodhje në rrugën "F. F.", "Y." dhe "K. Dëshmorët", Tiranë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

63. Sa i përket konstatimit se nuk ka informacion lidhur me regjistrimin e pasurisë, subjekti ka prapësuar se, së pari: (i) kontrata e shitjes me shtetasen Sh. M. është bërë para noterit dhe është regjistruar sipas legjislacionit në fuqi; (ii) ka paraqitur në ILDKPKI, së bashku me deklaratën *Vetting*, kontratën e blerjes së pasurisë nga babai Sh. Ç.; (iii) ka deklaruar si kontratën e dhurimit ashtu edhe atë të shitjes, akte të gjitha të bëra para noterit, si dhe në kontratën e dhurimit nuk ka përcaktuar vlerë sepse ka menduar se dhurata nuk vlerësohet; (iii) vlerësimi i saj është bërë pas rivlerësimit të pronës për efekt kredie. E gjithë shuma e çmimit të shitjes është marrë nëpërmjet bankës dhe nëpërmjet llogarisë së noterit sipas legjislacionit në fuqi.

Analiza e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

64. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, lidhur me dhurimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se: “[...] dhurimi nga prindërit e mi për të dy ne bashkëshortët të njësisë ambient shërbimi me adresë rruga ‘H. D.’ Tiranë, me sip. 44 m², sipas kontratës së dhurimit të datës 19.10.2012, është për një cilësi jete më të mirë për fëmijën e vet, si dhe shpërblim moral për respektin, dashurinë dhe përkujdesjen e pakufishme që kemi treguar dhe tregojmë për prindërit [...]”. Burimi i krijimit ka qenë nga hotel-bar-restorant “L.” në P., Pogradec, që u prish për interes publik sipas VKM-së përkatëse dhe u kompensua në vlerën monetare përkatëse, ku përfshihet edhe nxjerrja e të ardhurave prej tij për periudhën 2000 – 2015”.
65. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të bëjë me dije burimin e ligjshëm të krijimit për blerjen e kësaj pasurie nga prindërit e saj²³, duke i kërkuar gjithashtu edhe dokumentacionin ligjor të përfitimit të pronësisë prej tyre. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti është shprehur se të gjitha shpjegimet janë dhënë të detajuara në ILDKPKI dhe, për të provuar këtë, ka vënë në dispozicion dokumentacionin e titulluar “njoftim publik nr. *** prot., datë 9.12.2014, për të shpronësuarin, shtetasin Sh. Ç., i cili do të shpronësohet në masën 311,600 lekë për truallin dhe 14,400,513 lekë për ndërtesën në P., Komuna U., breg liqeni, bazuar në VKM-në nr. ***, datë 23.3.2000”.
66. Referuar dokumentacionit të administruar dhe atij të disponuar, Komisionit i ka rezultuar se, ndër të tjera, sipas QKB-së²⁴, shtetasi Sh. Ç.²⁵ është i regjistruar si person fizik në datën 9.6.2009, në QKB, me aktivitet “bar-kafe”, me ushtrim aktiviteti në rrugën “H. D.”, përballë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendndodhje që duket e njëjtë me adresën e njësisë së shërbimit të dhuruar në favor të subjektit të rivlerësimit, pra, duke krijuar bindjen se kjo pasuri ka qenë në përdorim të personit tjetër të lidhur që prej vitit 2009. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me sa më sipër, por kjo e fundit nuk ka dhënë shpjegime për këtë njësi dhe, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka bërë me dije se në dijeninë e saj aktiviteti ka qenë “bar-kafe”.
67. Nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se më anë të kontratës së qirasë së datës 18.11.2013, subjekti dhe bashkëshorti i kanë dhënë me qira ambientin z. E. Dh., ambient njësi shërbimi me sip. 44 m², me destinacionin biznes “bar-kafe” për një afat 2-vjeçar, kundrejt qirasë me vlerë 150,000 lekë/muaj. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të QKB-

²³Referuar ligjit nr. 84/2016, neni 3 i tij, duke qenë se prindërit e subjektit të rivlerësimit janë në një marrëdhënie interesi dhurimi, për këtë shkak, ata konsiderohen persona të tjerë të lidhur me të dhe bazuar në ligjin e sipërcituar, ata duhet të justifikojnë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së llojit njësi, dhuruar subjektit në vitin 2012.

²⁴Shkresë nr. *** prot., datë 17.2.2020.

²⁵Nga verifikimi i ekstraktit historik të regjistrimit tregtar dhe dokumentacionit bashkëlidhur tij për këtë subjekt, konstatohet se nëpërmjet prokurës së posaçme me nr. ***, datë 9.6.2009, z. Sh. Ç. ka emëruar avokaten K. D., si përfaqësuesen e tij ligjore në lidhje me hapjen e licencës dhe regjistrimin e tij në QKR dhe institucioneve të tjera si tatim-taksa, për kryerje aktiviteti bar.

së, konstatohet se në datën 21.11.2013 është regjistruar subjekti “E. Dh.”, person fizik, për ushtrimin e aktivitetit “bar-kafe”, me ushtrim aktiviteti në Tiranë, në rrugën “H. D.”, pallati përballë Prokurorisë, kati ***. Duket se të dyja shoqëritë tregtare, “Sh. Ç.” person fizik dhe “E. Dh.” person fizik, figurojnë të regjistruara me adresë ushtrimi aktiviteti në njësinë e shërbimit të dhuruar në favor të subjektit në tetor të vitit 2012, me status “aktiv”.

68. Nga sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie nga pala dhuruese, si edhe nuk ka depozituar dokumentacion për të evidentuar ligjshmërinë e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur/Sh. Ç., për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të arritura, si dhe për të shpjeguar sa më sipërcituar.
69. Gjithashtu, Komisioni, edhe pasi ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me dokumentacionin ligjor që provon pagesën e tatimit në burim mbi qiranë e ambientit me sip. 44 m², vëren se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime shteruese dhe nuk deklaroi në mënyrë kronologjike përdorimin e ambientit pas fitimit të pronësisë, nuk saktësoi periudhën e përdorimit nga secili subjekt/individ, si dhe nëse përdorimi ka qenë me apo pa kundërshtim dhe mbi të ardhurat e mundshme të përfituara prej saj, sipas periudhave përkatëse.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

70. Në prapësimet e depozituara subjekti ka shpjeguar se në deklaratën *Vetting* kanë përmendur burimet e krijimit të pasurisë dhe që është absolutisht e pamundur të provohet në kushtet e një ekonomie informale burimi i ligjshëm i kësaj pasurie. Subjekti ka shpjeguar se: “Prindërit dhe vëllezërit kanë qenë për vite me radhë në emigracion, kanë ushtruar aktivitet shetje me shumicë e pakicë për vite me radhë te tregu i medresesë dhe, për këtë, kemi paraqitur me deklaratën *Vetting* një pagesë taksë bashkie dhe se as prindërit e as vëllezërit nuk janë hetuar apo gjykuar kurrë për trafikë të paligjshme që do të sillte pasurimin e paligjshëm të tyre. Ata kanë punuar me ndershmëri dhe burimi i ligjshëm nuk mund të provohet për shkaqe të pavarura nga vullneti i tyre”.
71. Lidhur me periudhën e përdorimit të ambientit nga shtetasit E. Dh. dhe A. Ç., subjekti ka shpjeguar se kjo periudhë është pasqyruar në deklaratën *Vetting*, për të cilën është paguar edhe tatim-fitimi.

Vlerësimi i trupit gjykues

72. Komisioni, megjithëse i ka kërkuar në mënyrë të përsëritur si gjatë hetimit administrativ ashtu edhe pas dërgimit të rezultateve dhe kalimit të barrës së provës dokumentacionin ligjor justifikues lidhur me mënyrën e përfitimit të pronësisë dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj nga personi tjetër i lidhur (dhuruesi/prindërit e saj), konstaton se subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion ligjor, që të provonte konkretisht burimet e ligjshme në fjalë. Gjithashtu, në asnjë rast subjekti nuk deklaroi vlerën e blerjes së pasurisë nga pala dhuruese, duke mbajtur qëndrimin jobashkëpunues dhe duke u shprehur se këto prova i ka depozituar më parë në ILDKPKI.
73. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Klorinda Çela nuk arriti të provonte me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të personit tjetër të lidhur në mënyrë që ky i fundit të mundësonte blerjen e pasurisë së llojit “njësi shërbimi”, e cila më pas i është dhuruar subjektit dhe bashkëshortit të saj, në vitin 2012.

3. Ambient shërbimi me sip. 46 m², në rrugën “L. B.”, Tiranë

74. Pasuria e llojit “njësi shërbimi” me sip. 46 m², ndodhur në rrugën “L. B.”, Tiranë, është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2015, likuiduar plotësisht dhe e regjistruar në

ZVRPP-në Tiranë dhe si burim krijimi ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara sipas VKM-së nr. ***, datë 22.12.2014 për shpronësimin e bar-restorant “L.”, në shumën 7,000,000 lekë; dhe (ii) të ardhura nga qiraja me subjektin person fizik “A. C.”, datë 1.5.2015, në shumën prej 500,000 lekësh.

75. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar pasurinë e blerë në datën 17.8.2015, me vlerë të deklaruar pas rivlerësimit 21,000,000 lekë, si dhe detyrim të pashlyer ndaj shtetases M. Ç., që rrjedh nga huaja e marrë pa afat dhe pa interes, e konfirmuar sipas një deklarate noteriale për pagesë kësti ndaj shoqërisë “B.” sh.p.k., detyrimi i mbetur në total 700,000 lekë. Burim krijimi i kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* është deklaruar huaja e marrë nga prindërit, nëpërmjet llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank” në vlerën 14,000,000 lekë, e cila provohet edhe nga deklarata noteriale nr. ***, datë 29.10.2016.
76. Subjekti, e pyetur nga Komisioni lidhur mbi mospërputhjen e konstatuar midis çmimit të njësisë prej 7,500,000 lekësh, huas së marrë në shumën 14,000,000 lekë, si dhe deklarimit të burimeve në DIPP-në e vitit 2015 dhe deklaratës *Vetting*, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, është shprehur se: “[...] nuk ka mospërputhje midis burimit të pasurisë në fjalë në DIPP-në e vitit 2015 me burimin e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe se ka qenë vetëm një harresë, ndërsa lidhur me destinacionin e diferencës së shumës së huas është shpjeguar se në deklarin periodik vjetor dhe në deklarin *Vetting* është përdorur për blerjen e një pasurie tjetër”.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

77. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në datën 17.8.2015 znj. Klorinda Çela ka blerë nga shtetasit P. dhe E. J., pasurinë e llojit njësi shërbimi me sip. 46 m², ndodhur në rrugën “L. B.”, L., Tiranë, për çmimin 7,500,000 lekë. Subjekti ka transferuar në datën 14.8.2015, nga “Tirana Bank” shumën e sipërcituar në llogarinë e noteres R. R., person fizik, me përshkrimin “transaksion për tjetërsim pasurie shitblerjeje prone L.”. Në datën 20.8.2015, kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë dhe është nxjerrë certifikata për vërtetim pronësie nr. ***, në emër të subjektit Klorinda Çela.
78. Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga SGA Bank, me konfirmimin bankar të datës 30.12.2016, ka bërë me dije se subjekti dhe bashkëshorti kanë marrë një kredi bankare në shumën 21,000,000 lekë, me anë të kontratës së datës 9.5.2016.

Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie

79. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie shumën prej 7,000,000 lekësh, si pjesë e huas së marrë nga prindërit e saj, ku kjo shumë ka si burim të ardhurat e përfituara nga prindërit, si rrjedhojë e shpronësimit të bar-restorant “L.”– sipas VKM-së përkatëse²⁶.
80. Në vijim, nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar ka rezultuar se në datën 16.4.2015, në llogarinë bankare të z. Sh. Ç. në “Raiffeisen Bank” është kredituar shuma prej 14,712,113 lekësh dhe nga kjo shumë në datën 18.6.2015 nga llogaria e tij është transferuar në favor të znj. Klorinda Çela shuma prej 14,000,000 lekësh, ndërsa në datën 23.6.2015 nga

²⁶Me vendimin nr. ***, datë 5.5.2000, të KRRT-së Pogradec është miratuar destinacioni i sheshndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij për z. Sh. Ç., për objektin “lokal shërbimi” me sipërfaqe sheshndërtimi dhe sipërfaqe ndërtimi prej 190 m², me 2 kate. Me vendimin nr. ***, datë 12.6.2000, të KRRT-së Pogradec është miratuar leja e ndërtimit për z. Sh. Ç., për objektin “lokal shërbimi” në P.. Referuar certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar në datën 25.7.2002, z. Sh. Ç. ka pasur të regjistruar në pronësi të tij pasurinë e llojit arë + truall me sip. totale 2,600 m², nga të cilat 190 m² truall dhe 190 m² ndërtesë. Në datën 9.12.2014, Komuna H. – Pogradec ka nxjerrë njoftimin për shpronësim publik, për të shpronësuarin z. Sh. Ç. – identifikuar si pronar i ligjshëm i objektit bar-restorant “L.”, lokal shërbimi me 2 kate, i ndodhur në fshatin P., me sipërfaqe truall 190 m² dhe sipërfaqe ndërtesë 380 m², ku përcaktohet masa e shpërblimit në shumën prej 311,600 lekësh për truallin dhe në shumën prej 14,400,513 lekësh për ndërtesën. Nëpërmjet VKM-së nr. ***, datë 22.12.2014, është vendosur shpronësimi për interes publik për pasurinë e z. Sh. Ç. dhe është konfirmuar kompensimi financiar në total për shumën 14,712,113 lekë.

kjo llogari është transferuar në llogarinë e noteres R. R.²⁷ shuma 7,500,000 lekë me përshkrimin “blerje apartamenti nr. ***, z. k. ***, vol. ***”.

81. Në datën 6.8.2015, znj. Klorinda Çela ka transferuar nga llogaria e saj në “Raiffeisen Bank” po në llogarinë e saj në “Tirana Bank” shumën 7,001,000 lekë dhe në datën 14.8.2015, llogaria e saj në “Tirana Bank” është kredituar me shumën 600,000 lekë, nëpërmjet transfertës së bërë nga shtetasi A. Ç. me përshkrimin “pagesë qiraje për 4 muaj” dhe po në të njëjtën datë 14.8.2015, nga kjo llogari është transferuar në llogarinë e noteres R. R. shuma prej 7,500,000 lekësh²⁸.
82. Nëpërmjet një deklarate noteriale të datës 4.6.2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar se kanë marrë hua nga shtetasi Sh. dhe M. Ç. shumën 14,000,000 lekë në vitin 2015, me burim nga fondi i përfitur nga shpronësimi i restorant “L.”, në P., Pogradec dhe se këto të ardhura u përdorën prej tyre për blerjen e dy njësive tregtare në Tiranë. Ndërkohë lidhur me kthimin e huas ka rezultuar se pala huadhënëse, znj. M. Ç.²⁹, ka deklaruar se në datën 4.6.2016 huaja i është kthyer mbrapsht.
83. Referuar burimit të krijimit të deklaruar në deklaratën noteriale datë 29.10.2016, Komisioni konstaton se vetëm shuma prej 14,000,000 lekësh është transferuar në llogari të subjektit, ndërsa pjesa e mbetur nga vlera e shpronësimit, rreth 700,000 lekë³⁰ në datën 22.6.2015, është kaluar nga llogaria e z. Sh. Ç. në llogarinë e znj. M. Ç., në “Raiffeisen Bank” dhe se kjo shumë është investuar në depozitë me afat – shumë e pa tërhequr gjatë vitit 2015.
84. Nga sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se ka mospërputhje në deklaratimet kontradiktore të bëra lidhur me shumën e marrë hua në vitin 2015 nga subjekti i rivlerësimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

85. Trupi gjykues konstaton se edhe pas kalimit të barrës së provës me dërgimin e rezultateve, subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse/shteruese lidhur me këtë mospërputhje, për rrjedhojë konfirmohen rezultatet e hetimit administrativ.

Lidhur me shumën 500,000 lekë, si të ardhura nga qiradhënia

86. Në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e dyqanit nga shtetasi A. Ç.. Por, nga ana tjetër, në DIPP-në e vitit 2015 në deklarinimin e kësaj pasurie, subjekti i është referuar si burim krijimi për blerjen e pasurisë së llojit njësi, dhe gjithashtu sipas informacionit bankar të analizuar më sipër - transferta e kryer nga z. A. Ç. në llogarinë e personit të lidhur në datën 14.8.2015 me përshkrimin “pagesë qiraje për 4 muaj” në vlerën 600,000 lekë, ka shërbyer për krijimin e shumës 7,500,000 lekë – fond i transferuar për blerjen e pasurisë objekt analize.

²⁷Duket se fondet e transferuara në llogarinë e noteres R. R. në datën 23.6.2015, nuk kanë pasur destinacion shlyerjen e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi – pavarësisht se përshkrimi i transfertës referon të dhëna të kësaj të fundit - por të një pasurie tjetër, e cila do të trajtohet në vijim.

²⁸Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti (SWIFT bankar) konfirmohet se në llogari të noteres R. R. në “Alpha Bank” është transferuar në datën 17.8.2015 shuma prej 7,500,000 lekësh me përshkrimin “transaksion për tjetërsim pasurie shitblerje prone L.”.

²⁹Ndërsa, nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 29.10.2016, znj. M. Ç. ka deklaruar se së bashku me bashkëshortin, të ndjerin Sh. Ç., i kanë dhënë hua vajzës së tyre Klorinda Çela dhe dhëndrit K. Dh. shumën 14,700,000 lekë, në vitin 2015, nga të cilat shuma prej 14,000,000 lekësh, nëpërmjet bankës, dhe shuma prej 700,000 lekësh *cash* për blerjen e dy ambienteve që dëshironin të blinin. Burimi i të ardhurave është VKM për shpronësimin e bar-restorant “L.” me vendndodhje në P., Pogradec. Nga kjo shumë, vlera prej 14,000,000 lekësh i është shlyer në vitin 2016, pas marrjes së një kredie nga vajza dhe dhëndri.

³⁰Shumë e cila është pretenduar si e dhënë *cash*. Si rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2015 nuk do të pasqyrohet si e dhënë hua shuma prej 700,000 lekësh, e pretenduar nga subjekti si e marrë hua gjatë këtij viti nga prindërit e saj, krahas shumës 14,000,000 lekë.

87. Rezulton se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia e lokalit në pronësi, sipas kontratës së qirasë me subjektin “A. Ç.” person fizik³¹, nga data 1.5.2015 deri më 31.12.2015, shumën prej 1,200,000 lekësh dhe sikurse është përshkruar dhe analizuar edhe më lart, subjekti i rivlerësimit ka pasur ende detyrime të pashlyera ndaj shtetasit A. Ç., në shumën prej 2,000,000 lekësh, për huan e pretenduar si të marrë prej tij në vitin 2005, për blerjen e apartamentit të analizuar.
88. Nga sa më sipër është analizuar dhe konstatuar, Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme mbi marrëdhënien e qiradhënies mes subjektit, bashkëshortit dhe shtetasit A. Ç., mbi të ardhurat e deklaruara si të përfituara prej saj, përpara datës së nënshkrimit të kontratës së qirasë dhe para regjistrimit të adresës së dyqanit, të ardhura të cilat janë deklaruar si burim krijimi për pasurinë në fjalë.
89. Në këto kushte, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e sa u analizua dhe detajua më sipër. Edhe pas dërgimit të rezultateve subjekti nuk arriti të provonte me dokumentacion ligjor, si dhe të shpjegonte bindshëm për të kundërshtuar rezultatet e arritura në hetim, si rrjedhojë trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të shumës prej 500,000 lekësh të pretenduar si të përfituar nga marrëdhënia e qiradhënies me personin fizik “A. Ç.”.

4. Garazhet me sipërfaqe 18.9 m² dhe 18.2 m², në Tiranë

90. Dy pasuritë e llojit garazh, me sip. 18.9 m² dhe 18.2 m², në rrugën “D. B.”, Tiranë, janë përfituar me kontratën e shitjes së pasurisë nr. ***, datë 10.4.2015, nga shoqëria shitëse “E.” sh.p.k., me vlerë 4,500 euro/secili dhe konstatohet se në DIPP-në e vitit 2015 subjekti nuk ka deklaruar blerjen e pasurive në fjalë. Gjithashtu, nga ZVRPP-ja Tiranë konfirmohet regjistrimi i pasurive në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj.
91. Ndërsa nga shqyrtimi i deklaratës Vetting ka rezultuar se subjekti ka deklaruar burimet e krijimit të pasurive të lartpërmendura si vijon: (i) të ardhurat e saj nga paga si gjyqtare; (ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortit si gjyqtar; dhe (iii) të ardhurat nga qiradhënia e shtetasit E. Dh., të ambientit njësi shërbimi në rrugën “H. D.” Tiranë.
92. E pyetur nga Komisioni lidhur me arsyen e mosdeklarimit në DIPP-në e viteve 2015 dhe 2016 të pasurive, si dhe të burimit të ligjshëm për kryerjen e pagesës për blerjen e garazheve, subjekti ka shpjeguar se: “[...] në dijeninë time të dy garazhet janë deklaruar nga unë dhe bashkëshorti im në deklaratimet periodike vjetore. Gjithashtu, dhe në deklaratën Vetting. Janë paraqitur pranë ILDKPKI-së të gjitha provat shkresore. Burimet e të ardhurave janë parashtruar te deklarata Vetting dhe janë paraqitur gjithë provat shkresore të nevojshme [...]”.
93. Nga sa më sipër, Komisioni konstaton se në kundërshtim me parashikimet e bëra në germën “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar, subjekti nuk ka deklaruar këto pasuri të paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to.

³¹Në analizimin e marrëdhënies me shtetasin A. Ç., sikurse është përmendur edhe më herët, Komisioni evidentoi faktet se bazuar në kontratën e datës 16.7.2015, “A. Ç.”, person fizik, ka marrë me qira nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, ambientin e llojit njësi shërbimi me sip. 44 m² – me qira mujore në vlerën 172,500 lekë dhe se në këtë kontratë përcaktohet se afati i saj ka filluar në datën 1.5.2015. Ndërkohë, “A. Ç.”, person fizik, ka regjistruar në QKB si adresë sekondare dyqanin e marrë me qira, në datën 11.11.2015.

Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni për këto pasuri, lidhur me burimet e krijimit të këtyre pasurive

94. Siç është përshkruar më sipër, në deklaratën Vetting subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të këtyre pasurive: (i) të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit; dhe (ii) të ardhurat nga qiradhënia e dyqanit të ndodhur në rrugën “H. D.”, Tiranë. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, ndër vite, në ILDKPKI, ka rezultuar se për periudhën 2003 – 2013 as subjekti i rivlerësimit dhe as bashkëshorti nuk kanë deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash*.
95. Ndërsa, në DIPP-në e vitit 2014, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën prej 1,400,000 lekësh, me përshkrim dhe burim krijimi “para *cash* jashtë sistemit bankar si rezultat i qirasë së lokalit në pronësinë time dhe të bashkëshortit”.
96. Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, lidhur me këtë marrëdhënie qiraje, duket se për vitin 2014 është mbajtur, deklaruar dhe paguar tatimi në burim nga “E. Dh.” person fizik, shuma prej 180,000 lekësh, për vlerën e qirasë së deklaruar në shumën prej 1,800,000 lekësh. Në DIPP-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia sipas kontratës së qirasë me shtetasin E. Dh., nga data 1.1.2015 deri më 30.4.2015, në shumën 600,000 lekë. Por rezulton se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiradhënia për vitin 2015.
97. Komisioni vëren se krahas mosdeklarimit të pasurive objekt vlerësimi në DIPP-në e vitit 2015, subjekti, gjithashtu, nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në fjalë në DIPP-në e vitit 2014 dhe as në vitet e mëpasshme. Pra, duket se këto likuiditete nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i pasurive të llojit garazh, të blera në datën 10.4.2015.
98. Në kushtet kur kontrata e qiradhënies është lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit E. Dh. – si individ, referuar legjislacionit tatimor³² të ardhura të paguara nga E. Dh. si individ, individi përfitues i të ardhurave është i detyruar të deklarojë dhe të paguajë në organin tatimor tatimin përkatës për të ardhurat e realizuara.
99. Nga sa më sipër, Komisioni ka përlloritur në këto kushte mundësitë e subjektit dhe të bashkëshortit për të përballuar pagesat e kryera për këto pasuri me të ardhurat e tyre nga pagat gjatë harkut kohor 1.1.2015 – 10.4.2015.

Tabela nr. 2

| Analiza financiare, periudha 1.1.2015 – 10.4.2015 | Vlerat në lekë |
|--|-----------------------|
| Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit | 363 528 |
| Të ardhura nga paga e bashkëshortit | 363 047 |
| Shpenzim për blerjen e dy pasurive garazh, në vlerën 9,000 euro. | -1 262 520 |
| Ndryshim likuiditeti | -472 121 |
| Shpenzime jetike | -245 782 |
| Shpenzime për kredinë në “Raiffeisen Bank” | -261 350 |
| Rezultati | - 1 515 198 |

³²Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe Udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006, i ministrit të Financave, dalë në zbatim të tij.

100. Komisioni thekson sërish faktin se edhe pas kalimit të barrës së provës subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime dhe nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga qiradhënia e lokalit gjatë vitit 2015.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

101. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se pasuritë e llojit garazh janë deklaruar si prej saj në deklaratën *Vetting*, po ashtu edhe nga bashkëshorti. Lidhur me analizën financiare të Komisionit, subjekti ka pretenduar se është e njëanshme dhe nuk është e bazuar në të ardhura reale. Në deklaratat e pasurisë të bëra nga subjekti, por edhe nga bashkëshorti, pranë ILDKPKI-së, janë deklaruar burimet e këtyre të ardhurave dhe personat nga të cilët janë përfitur.

102. Lidhur me burimin e ligjshëm, subjekti ka shpjeguar se i vetmi problem në burimet e krijimit ka qenë provimi i ligjshëm i tyre, pasi në atë kohë ka qenë ekonomia informale dhe është absolutisht e pamundur të provohen të ardhurat e fituara nga emigracioni i paligjshëm dhe punësimi i paligjshëm i të afërmeve.

Vlerësimi i trupit gjykues

103. Komisioni thekson sërish faktin se edhe pas kalimit të barrës së provës subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime dhe nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar se të ardhurat e deklaruara, si të përfituara nga qiradhënia e lokalit gjatë vitit 2015, ishin të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, madje ka pohuar se nuk mund të provonte këtë fakt për shkak të informalitetit.

104. Nisur nga sa më sipër, bazuar në vetëdeklarimit e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e pasurive në analizë, pasi ka rezultuar një mungesë financiare prej 1.515.198 lekësh.

5. Njësi shërbimi me sip. 47 m², në rrugën “D. B.”, Tiranë

105. Pasuria e llojit “njësi” me sip. 47 m², në rrugën “D. B.” Tiranë, prenotuar nga shoqëria “B.” sh.p.k., me çmimin 7,500,000 lekë, pasuri e përfitur nëpërmjet kontratës së premtimit nr. ***, datë 16.7.2015, ku çmimi është paguar totalisht në llogarinë e noteres dhe transferuar në llogari të shoqërisë. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit për blerjen e kësaj pasurie të ardhura nga VKM-ja me nr. ***, datë 22.12.2004, për shpronësim të bar-restorant “L.”, në vlerën 7,500,000 lekë.

106. Referuar DIPP-së së vitit 2015 konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: ambient me sip. 235.18 m² (i përbërë nga 4 njësi) në rrugën “D. B.”, me kontratë prenotimi, pronë e tipit karabina me leje ndërtimi, ku: (i) kontrata e parë me nr. ***, datë 16.7.2015; dhe (ii) kontrata e dytë nr. ***, datë 16.7.2015, para noteres R. R., paguar totalisht kontrata e parë në shumën 7,500,000 lekë dhe si burim krijimi është deklaruar VKM-ja me nr. *** datë 22.12.2014, për shpronësim të bar-restorant “L.”.

107. Ndërkohë, në deklaratën *Vetting*, si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (i) të ardhurat nga paga si gjyqtare; (ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortit si gjyqtar; (iii) huaja e dhënë nga prindërit e saj në vlerën totale 14,000,000 lekë; dhe (iv) të ardhurat nga qiradhënia e ambientit të shërbimit me vendndodhje në rrugën “H. D.”, Tiranë, dhënë me qira shtetasit A. Ç..

108. Ka rezultuar se me kontratën³³ e datës 16.7.2015, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë porositur nga shoqëria “B.” sh.p.k. pasurinë e llojit njësi shërbimi me sip. 47 m², dyqani nr. ***, seksioni ***, në objektin që po ndërtohej nga kjo shoqëri në rrugën “D. B.”, Tiranë. Referuar kësaj kontrate, çmimi i përcaktuar midis palëve për shitjen e kësaj pasurie është në vlerën 7,500,000 lekë dhe se shuma është likuiduar tërësisht me nënshkrimin e saj, nëpërmjet llogarisë së noteres R. R. në “Raiffeisen Bank”. Kontrata për shitblerjen³⁴ e kësaj pasurie është nënshkruar në datën 5.10.2018.
109. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie ka rezultuar se në datën 18.6.2015, nga llogaria e babait të subjektit, z. Sh. Ç., në “Raiffeisen Bank”, është transferuar në favor të znj. Klorinda Çela shuma 14,000,000 lekë, me burim nga të ardhurat e përfituara nga shpronësimi për interes publik i bar-restorant “L.”. Më tej, nga kjo llogari në “Raiffeisen Bank”, në datën 23.6.2015, transferohet në llogarinë e noteres R. R. shuma 7,500,000 lekë dhe, në vijim, duket se këto fonde në datën 16.7.2015 transferohen nga llogaria e noterit³⁵ në favor të shoqërisë “B.” sh.p.k. me përshkrimin “lik. kontrate nr. ***, datë 16.7.2015”.
110. Nga sa më sipër, ka rezultuar se si burim për pagesën e kryer për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi kanë shërbyer të ardhurat e marra hua nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, ndonëse në deklaratën *Vetting* citohej/përshkruhen burime të tjera.
111. Trupi gjykues, pas verifikimit, konstaton se si burim për pagesën e kryer për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi kanë shërbyer të ardhurat e marra hua nga prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ligjshmëria e të cilave është analizuar si më sipër në këtë vendim. Gjithsesi, Komisioni thekson faktin se në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të kësaj pasurie.

6. Njësi shërbimi me sip. totale 188.18 m², në rrugën “D. B.”, Tiranë

112. Pasuria e llojit njësi shërbimi me sip. totale 188.18 m², e përbërë përkatësisht nga pasuritë me sipërfaqe 47.23 m², 42.62 m² dhe 98.33 m², të ndodhura në rrugën “D. B.”, Tiranë, të cilat janë porositur në datën 16.7.2015, nga shoqëria “B.” sh.p.k., me vlerë totale 246,429 euro, nëse merren në dorëzim të përfunduara plotësisht dhe me vlerë 105,000 euro nëse merren në dorëzim në gjendje karabina.
113. Konstatohet nga Komisioni se këto pasuri nuk janë deklaruar specifikisht nga subjekti në DIPP-në e vitit 2015, por janë deklaruar “pasuri e llojit ambient me sipërfaqe 235.18 m², në rrugën ‘D. B.’, Tiranë, pronë e tipit karabina, me leje ndërtimi, përfutur me kontratat e prenotimit³⁶.”
114. Paguar totalisht kontrata e parë, shuma 7,500,000 lekë dhe si burim krijimi është deklaruar VKM -ja me nr. ***, datë 22.12.2014, për shpronësim të bar-restorant L.” dhe në seksionin e detyrimeve është deklaruar kontrata e prenotimit nr. ***, datë 16.7.2015, me shoqërinë “B.” sh.p.k. dhe si detyrim i mbetur shuma prej 246,429 euro³⁷.
115. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar burimin e krijimit të pasurive në fjalë nga: (i) të ardhurat nga paga e saj si gjyqtare; (ii) të ardhurat e bashkëshortit nga paga si gjyqtar; (iii)

³³Kontratë prenotimi nr. ***, datë 16.7.2015, redaktuar nga noteri publik, znj. R. R. (aneks 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁴Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 5.10.2018 (kontratë e dërguar nga noteri publik, znj. M. Sh., me shkresën e datës 2.6.2021, protokolluar me nr. *** prot., datë 6.6.2021, në Komision).

³⁵Subjekti ka depozituar dokumentin bankar “njoftim debitimi”, datë 16.7.2015 (ndodhur në Aneks 4/6, në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁶Kontrata e parë me nr. ***, datë 16.7.2015 dhe kontrata e dytë nr. ***, datë 16.7.2015, para noteres R. R..

³⁷Në DPV-në e vitit 2016, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Detyrimi ndaj shoqërisë ‘B.sh.p.k., lidhur me blerjen e një njësie shërbimi e vërtetuar me kontratën e prenotimit me nr. ***, datë 16.7.2015 (karabina). Shlyer vlera 50,000 euro nëpërmjet bankës nga kredia bankare e marrë dhe gjendja e detyrimit të mbetur është 55,000 euro”.

kredia e marrë në bankën “Societe Generale Albania”, në shumën 21,000,000 lekë; (iv) të ardhurat nga qiraja e ambientit njësi në rrugën “H. D.”, Tiranë; (v) të ardhura nga qiraja e ambientit njësi në rrugën “L. B.”, Tiranë³⁸.

116. Subjekti, e pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka bërë me dije se: “[...] nuk ishte vetëm kjo shume që ju përmendni. Në kontratë ishte përcaktuar shuma 105,000 euro nëse dorëzohej në gjendjen karabina. Në deklarin periodik vjetor dhe në deklaratën Vetting është deklaruar që pasuritë janë marrë në dorëzim karabina dhe jo e përfunduar plotësisht. Pagesat janë deklaruar në deklaratën Vetting dhe në deklarin periodik vjetor, ku është paraqitur edhe marrja në dorëzim me akt noterial nga ana e shoqërisë ‘B. sh.p.k. në gjendje karabina. Edhe burimi i shumës 105,000 euro është përcaktuar në deklarin periodik vjetor dhe në deklaratën Vetting. Janë dorëzuar prova shkresore me akt noterial bashkë me deklaratën Vetting. Tani që po ju shkruaj po bëjmë ndarjen e pronës në dy njësi dhe po merremi me instalimet e ujit dhe energjisë, të cilat mungojnë për shkak të marrjes karabina, si dhe suvatimet e brendshme. Kur të përfundojë do ju paraqes dhe faturën që provon këto shpenzime. Këto shpenzime po mbulohen nga paga ime dhe e bashkëshortit [...]”.

Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie

117. Referuar planit të pagesave/mënyrës së likuidimit për pasuritë në analizë, është përcaktuar nga palët, si vijon: (i) me nënshkrimin e kontratës do të bëhet pagesa e kështit të parë në vlerën 50,000 euro, brenda muajit shtator 2015; (ii) kështi i dytë, në vlerën 50,000 euro, do të likuidohet brenda muajit mars 2016; (iii) kështi i tretë, në vlerën 50,000 euro, do të likuidohet brenda muajit nëntor 2016; (iv) kështi i katërt, në vlerën 50,000 euro, do të likuidohet brenda muajit prill 2017; (v) kështi i pestë dhe i fundit, në vlerën 46,429 euro, do të likuidohet brenda muajit gusht 2017.
118. Bazuar në përcaktimet e bëra në kontratën e prenotimit³⁹ të datës 16.7.2015 dhe në planin e pagesave, Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën 1.1.2015 – 30.9.2015, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës së kështit të parë në shumën 50,000 euro, për blerjen e tri pasurive objekt vlerësimi, të pasqyruar në tabelën vijuese.

Tabela nr. 3

| Analiza financiare për periudhën 1.1.2015 – 30.9.2015 | Vlerat në lekë |
|---|-----------------------|
| Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit | 808 087 |
| Të ardhura nga paga e bashkëshortit | 816 857 |
| Të ardhura nga qiradhënia e dyqanit në rrugën “H. D.”, Tiranë | 733 125 |
| Hua e marrë nga prindërit e subjektit | 14 000 000 |
| Dy pasuritë e llojit garazh, me sip. 18.9 m ² dhe 18.2 m ² | -1 262 520 |
| Njësi shërbimi me sip. 46 m ² , në rrugën “L. B.” L., Tiranë | -7 500 000 |
| Njësi shërbimi nr. ***, me sip. 47 m ² , në rrugën “D. B.”, Tiranë | -7 500 000 |
| Njësitë e shërbimit nr. ***, ***, ***, me sip. 188.18 m ² , në “D. B.” | -6 882 500 |
| Ndryshim likuiditeti | -709 546 |
| Shpenzime jetike | -663 611 |
| Shpenzime për kredinë në “Raiffeisen Bank”, disbursuar datë 8.10.2010 | -5 903 391 |

³⁸Kontrata e qirasë, datë 28.1.2016, lidhur me Postën Shqiptare.

³⁹Kontrata e prenotimit nr. ***, datë 16.7.2015, redaktuar nga notere R. R..

| | |
|--------------------------------------|--------------------|
| Shpenzime për udhëtime jashtë vendit | -164 492 |
| Shpenzime për arsimin e vajzës | -877 282 |
| Rezultati | -15 105 273 |

119. Nga sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e këstit të parë për blerjen e pasurive objekt vlerësimi, për sa kohë ka rezultuar një mungesë mjetesh monetare të ligjshme në vlerën 15,105,273 lekë.
120. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga OTP Bank⁴⁰ është konfirmuar se, në datën 9.5.2016, midis bankës, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj është lidhur kontrata e huas në shumën 21,000,000 lekë, me objekt investimi në pasuri të paluajtshme. Nga lëvizjet e llogarisë konfirmohet se në datën 18.5.2016 është disbursuar kredia në vlerën 21,000,000 lekë, në llogarinë dyemërore të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur dhe se në datën 19.5.2016 shuma prej 7,000,000 lekësh është transferuar në llogari të shoqërisë “B.” sh.p.k. me përshkrimin “kalim fondi sipas kontratës së prenotimit nr. ***, datë 16.7.2015”.
121. Ndërsa, pjesa tjetër e fondeve me burim nga kredia në shumën 13,851,000 lekë, në datën 23.5.2016, është transferuar në llogarinë dyemërore të subjektit dhe personit të lidhur në BKT dhe, në vijim, e gjithë shuma është tërhequr *cash* nga subjekti dhe personi i lidhur në tri pjesë: (i) në datën 27.5.2016, tërhequr shuma 8,000,000 lekë; (ii) në datën 30.5.2015 tërhequr shuma 4,000,000 lekë; dhe (iii) në datën 3.6.2016 tërhequr shuma 1,850,000 lekë.
122. Në vijim të hetimit administrativ, Komisioni iu drejtua noterëve, të cilët pas kërkesës së bërë⁴¹ noterëve publikë, R. R.⁴² dhe M. Sh.⁴³, dërguan dokumentacionin e kërkuar – kontrata dhe deklarata noteriale, të lidhura me këto tri njësi shërbimi.
123. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se me deklaratën noteriale të datës 13.5.2016, sipërmarrësi “B.” sh.p.k., porositësit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti deklarojnë se *kanë nënshkruar midis tyre një kontratë prenotimi nr. ***, datë 16.7.2015, për prenotimin nga pala porositëse, të tri njësite⁴⁴, nga ku pala sipërmarrëse ka deklaruar se bie dakord që t’i dorëzojë porositësit ambientet e sipërcituara, në gjendje karabina pa punime të rifiniturës, ku çmimi total për këto njësi të prenotuara do të jetë 105,000 euro.*
124. Referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 15.6.2016, përpara noterit publik, znj. R. R., sipërmarrësi “B.” sh.p.k., porositësit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, deklarojnë se *kanë nënshkruar midis tyre një kontratë prenotimi nr. ***, datë 16.7.2015, për prenotimin nga pala porositëse të tri njësite, si dhe një deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.5.2016, për përcaktimin e mënyrës së dorëzimit të ambienteve, objekt i kontratës së prenotimit. Për sa më sipër, bazuar në negociatat e zhvilluara midis palëve në marrëdhënie palët bien dakord të anulojnë deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.5.2016, për përcaktimin e mënyrës së dorëzimit të ambienteve objekt i kontratës së prenotimit, duke deklaruar se këtë gjë do ta përcaktojnë në momentin e marrjes në dorëzim të ambienteve.*

⁴⁰Shkresë nr. *** prot., datë 12.3.2020. Garancia e ofruar për sigurimin e kredisë është përcaktuar të jetë hipoteka mbi pasurinë e paluajtshme të llojit njësi me sip. 44 m² dhe me nr. pasurie ***, ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, në rrugën “H. D.”, Tiranë, dhe hipoteka mbi pasurinë e paluajtshme në pronësi të znj. Klorinda Çela, e llojit njësi shërbimi me sip. 46 m², me nr. pasurie ***, ndodhur në zonën kadastrale nr. ***, në rrugën “L. B.”, Tiranë.

⁴¹Shkresat nr. *** prot., dhe nr. *** prot., të datës 27.5.2021.

⁴²Shkresë e datës 10.6.2021, protokolluar me nr. *** prot., datë 14.6.2021 në Komision.

⁴³Shkresë e datës 2.6.2021, protokolluar me nr. *** prot., datë 4.6.2021 në Komision.

⁴⁴Respektivisht: (1) pasuria e llojit njësi me sip. 47.23 m², dyqani nr. ***; (2) pasuria e llojit njësi me sip. 46.42 m², dyqani nr. ***; (3) pasuria e llojit njësi me sip. 98.83 m², dyqani nr.***.

125. Dokumentacioni i administruar nga RNSH-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 28.1.2020, ka informuar mbi ekzistencën e deklaratës nr. ***, datë 4.6.2018, për detyrim njohje, të nënshkruar mes shoqërisë “B.” sh.p.k. dhe shtetasve K. Dh. dhe Klorinda Çela. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 4.6.2018, sipërmarrësi “B.” sh.p.k. dhe porositësit kanë deklaruar se *kanë nënshkruar midis tyre një kontratë prenotimi nr. ***, datë 16.7.2015, për prenotim nga pala porositëse të tri njësive, si edhe një deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.5.2016, për përcaktimin e mënyrës së dorëzimit të ambienteve, objekt i kontratës së prenotimit*⁴⁵.
126. Në datën 5.10.2018 është nënshkruar kontrata nr. *** për shitblerjen e njësive në analizë, në të cilën përcaktohet çmimi total i tyre në vlerën 105,000 euro⁴⁶.
127. Nga verifikimi dhe analizimi i deklaratave noteriale të cituara si më sipër, duket se në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, por edhe në vijim gjatë vitit 2017 nuk ka pasur ndonjë marrëveshje në fuqi mes palëve për marrjen në dorëzim të pasurive në gjendje karabina. Si rrjedhojë, në referim të kontratës së prenotimit të datës 16.7.2015, në kushtet e mungesës së marrëveshjes mes palëve, çmimi i plotë në shumën 246,429 euro, do të duhej të paguhej deri brenda muajit gusht të vitit 2017.
128. Për më tepër, duket të ketë mospërputhje midis deklarimeve të bëra në deklaratën noteriale të datës 5.11.2019, pasi në të referohet fakti se katër njësitë janë blerë në vlerën 105,000 euro, ndërkohë që sipas vetëdeklarimeve të subjektit janë blerë nga shoqëria “B.” sh.p.k., katër njësi shërbimi, njëra me çmimin 7,500,000 lekë dhe 3 të tjerat me çmim total prej 105,000 euro.
129. Në vijim të hetimeve të kryera për këto pasuri, Komisioni i kërkoi informacion të detajuar shoqërisë “B.” sh.p.k. lidhur me objektin e ndërtuar prej saj, prenotimin, pagesën e çmimit, si edhe mbi mënyrën e dorëzimit të tri njësive objekt vlerësimi. Por, kjo shoqëri nuk bëri me dije dhe nuk depozitoi ndonjë dokumentacion provues për momentin e kolaudimit të objektit dhe momentin e mënyrën e dorëzimit të tri njësive të shërbimit, subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk u dërgua informacion mbi mënyrën dhe periudhën e likuidimit të çmimit për blerjen e këtyre njësive dhe as për faktin nëse nga porositësi janë kryer punime shtesë.
130. Gjithashtu, nga subjekti nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor provues lidhur me këto pasuri, i cili në përmbushje të përcaktimeve të bëra në kontratën e prenotimit të datës 16.7.2015 të evidentonte faktin e dakordësisë së palëve për dorëzimin e ambienteve në gjendje karabina dhe as ndonjë procesverbal dorëzimi. Subjekti, ndër të tjera, nuk ka

⁴⁵Gjithashtu, bazuar në negociatat e zhvilluara midis palëve në marrëdhënie, palët kanë rënë dakord të anulojnë deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.5.2016, për përcaktimin e mënyrës së dorëzimit të ambienteve, objekt i kontratës së prenotimit, duke deklaruar se këtë gjë do ta përcaktojnë në momentin e dorëzimit të ambienteve. Në datën 20.1.2018, sipërmarrësi, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “B.” sh.p.k., me administrator, z. R. B., i dorëzoi porositësve K. Dh. dhe Klorinda Çela ambientin në gjendje karabinaje pa punime të rifiniturës me çmim total 105,000 euro, sipas kontratës së prenotimit nr. ***, datë 16.7.2015, për prenotimin e tri njësive, respektivisht: (1) pasuria e llojit njësi me sip. 47.23 m², dyqani nr. ***; (2) pasuria e llojit njësi me sip. 46.42 m², dyqani nr. ***; (3) pasuria e llojit njësi me sip. 98.83 m², dyqani nr. ***.

⁴⁶Nga informacioni i përcjellë nga RNSH-ja, është evidentuar edhe një deklaratë me përmbajtje të tjera, nr. ***, datë 5.11.2019, redaktuar nga noteri publik, znj. M. Sh., në të cilën sipërmarrësi “B.” sh.p.k. dhe porositësit kanë deklaruar se: *“Me njëri-tjetrin kanë nënshkruar dy kontrata sipërmarrjeje nr. ***, datë 16.7.2015, për marrëveshje ndërtimi nga shoqëria e sipërcituar, një njësi të emërtuar me nr. *** me vlerë 7,500,000 lekë, si dhe kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 16.7.2015 për marrëveshje ndërtimi nga shoqëria e sipërcituar tri njësi të emërtuar me nr. ***, ***, *** me vlerë 246,429 euro. Gjithashtu, në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 16.7.2015, thuhet se në rast se ambientet e mësipërme do të dorëzohen karabina pa rifinitura, do të kenë një vlerë totale prej 105,000 euro. Sot, përpara noterit, palët sa më sipër deklarojnë se shuma në total për blerjen e katër ambienteve (4-njësive) është dorëzuar në gjendjen karabina dhe pa rifinitura. Pra, vlera e tyre përfundimisht në total do të ishte 105,000 euro (njëqind e pesëmijë) euro, shumë e cila është shlyer në total sipas mandateve dhe se palët nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit”*.

deklaruar investime/punime të kryera mbi këto tri njësi, ndërkohë që nga fotot e dërguara nga shoqëria “B.” sh.p.k. duket se për të tria njësitë janë kryer/përfunduar punimet e plota.

131. Nga sa më sipër, ka rezultuar se nuk provohen pretendimet e subjektit se këto njësi janë marrë në dorëzim karabina dhe se çmimi total i tyre ka qenë 105,000 euro dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare paraprake të Komisionit do të reflektohet si çmim blerje i tri njësie objekt vlerësimi, shuma 246,429 euro, për sa kohë subjekti nuk ka deklaruar kryerjen e shpenzimeve për përfundimin e punimeve, të pretenduara si të përballuara prej familjes.
132. Bazuar në kontratën e prenotimit të datës 16.7.2015, gjatë vitit 2016 subjekti ka pasur detyrim të shlyente shumën 100,000 euro, konkretisht, këstin e dytë në shumën 50,000 euro brenda muajit mars 2016 dhe këstin e tretë në shumën 50,000 euro brenda muajit nëntor 2016. Në mungesë të evidencave të sakta për datat e kryerjes së këtyre pagesave, si edhe në konsideratë të faktit se për vitin 2016 u evidentua pagesa e kryer në favor të shoqërisë “B.” sh.p.k. në shumën 7,000,000 lekë me burim fondet e përfituara nga kredia në OTP Bank.
133. Për sa më sipër, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë të vitit 2016, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit për kryerjen e pagesës në shumën 100,000 euro për shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurive, si vijon:

Tabela nr. 4

| Analiza financiare, viti 2016 | Vlerat në lekë |
|---|-----------------------|
| Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit | 1 078 005 |
| Të ardhura nga paga e bashkëshortit | 1 071 401 |
| Të ardhura nga qiraja e njësisë, rruga “H. D.” | 1 759 500 |
| Të ardhura nga qiraja nga Posta Shqiptare, rruga “L* B*” | 748 000 |
| Kredi tek OTP Bank (ish-Societe Generale Albania) | 21 000 000 |
| Ndryshim likuiditeti | -1 421 614 |
| Shpenzime jetike | -940 368 |
| Shpenzime për kredinë tek OTP Bank, disbursuar datë 18.5.2016 | -1 155 000 |
| Shpenzime për pagesën e këstit II dhe III, për 3 njësitë, 100,000 euro. | -13 527 000 |
| Shpenzime për udhëtime jashtë vendit | -476 150 |
| Shpenzime për shlyerje huaje ndaj prindërve të subjektit | -14 000 000 |
| Shpenzime për arsimin e vajzës | -500 499 |
| Rezultati | -3 520 498 |

134. Për sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e këstit të dytë dhe të tretë për blerjen e pasurive objekt vlerësimi.
135. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet dhe provat e saj në lidhje me konstatimin e mësipërm. Edhe në dërgimin e rezultateve subjekti nuk depozitoi në prapësimet e dërguara shpjegime shteruese dhe nuk depozitoi prova për të kundërshtuar rezultatin e arritur të hetimit.
136. Si përfundim, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e këstit të parë për likuidimin e çmimit të pasurive objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e gremës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

137. Gjithashtu, në vijim, Komisioni konstaton se gjatë viteve 2016 – 2017 janë depozituar *cash* nga persona të tretë vlera monetare për shlyerjen e kësteve të kredisë, të marra nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në OTP Bank. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare Komisioni ka konstatuar se përgjatë viteve 2016 dhe 2017 janë depozituar *cash* nga persona të tretë vlera monetare për shlyerjen e kësteve të kredisë, të marra nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në OTP Bank dhe, konkretisht, nga shtetasit: M. C. shumën 2,475,000 lekë; E. M. shumën 165,000 lekë; F. M. shumën 165,000 lekë; H. M. shumën 165,000 lekë; dhe A. C. shumën 527,000 lekë.
138. Sa më sipër, në kushtet kur fondet e depozituara apo të transferuara nga shtetasit e sipërcituar kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga subjekti dhe bashkëshorti, në referim të pikës 14 të nenit 3 si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se shtetasit e sipërcituar bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojnë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të depozituara apo të transferuara në llogarinë bankare të personit të lidhur.
139. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të identifikojë me gjeneralitete të plota shtetasit që kanë kryer këto depozitime në llogarinë e përbashkët me bashkëshortin e saj në OTP Bank, si dhe të deklarojë mbi marrëdhënien e saj apo të personit të lidhur me ta.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

140. Nëpërmjet prapësimeve të depozituara, subjekti i rivlerësimit, lidhur me identitetin e shtetasve si më sipër, ka bërë me dije se në deklaratën *Vetting*, së bashku me bashkëshortin, kanë pasqyruar identitetin e shtetasve dhe se kanë paraqitur të gjitha provat e nevojshme lidhur me transaksionet për blerjen e kësaj pasurie, si dhe se as ajo dhe as bashkëshorti i saj nuk kanë pasur asnjëherë gjykime me asnjë nga shtetasit e përfshirë në këtë veprim financiar.
141. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave subjekti ka bërë me dije se burimi i të ardhurave është tërësisht i ligjshëm dhe i pasqyruar në deklaratën *Vetting*.

Vlerësimi i trupit gjykues

142. Në kushtet kur subjekti nuk paraqiti, as gjatë hetimit administrativ dhe as pasi është njohur me rezultatet e hetimit nëpërmjet prapësimeve të dërguara, asnjë dokumentacion ligjor justifikues, si edhe në konsideratë të faktit se nuk ka deklaruar ndër vite hua/të apo dhurim/et nga shtetasit e sipërcituar, që lidhen me këto depozitime apo transferta bankare dhe, për më tepër, nisur edhe nga fakti se shtetasit e sipërcituar nuk kanë konfirmuar marrëdhënie huaje apo dhurimi⁴⁷, si dhe për aq kohë sa nuk është depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e tyre, trupi gjykues vlerëson se në analizën financiare e gjithë vlera e kredisë së shlyer është shumë e paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur. Për rrjedhojë, lidhur me këto pasuri, konfirmohet pamundësia financiare me burime të ligjshme sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, përkatësisht, në vlerat negative 15,105,273 lekë në vitin 2015 dhe 3,520,498 lekë për vitin 2016.

7. Pasuri në proces legalizimi, në rrugën “Gj. L.”, Tiranë

143. Kjo pasuri në proces legalizimi, me deklarues vjehrrin e subjektit të rivlerësimit, z. V. Dh., është deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*. Në DIPP-të vjetore të depozituara ndër vite në ILDKPKI, subjekti nuk ka deklaruar këtë pasuri apo të drejtat reale mbi të, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe nëse ka kontribuar në krijimin e saj.

⁴⁷Sipas parashikimit të bërë në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

144. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, lidhur me këtë pasuri⁴⁸, konfirmohet se nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit për legalizim objekti z. V. Dh. ka vetëdeklaruar ndërtimin e objektit informal prej 1-kat, me sipërfaqe ndërtimore 70 m², ndodhur në rrugën “Gj. L.”, Njësinë Bashkiake Nr. ***, Tiranë. Referuar vetëdeklarimit ky objekt është ndërtuar në vitin 1992. Lidhur me këtë pasuri ALUIZNI, me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2017, ka bërë me dije se subjekti⁴⁹ dhe bashkëshorti nuk figurojnë aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal⁵⁰.
145. E pyetur nga Komisioni lidhur me këtë pasuri për periudhën e ndërtimit të këtij objekti, kontributin e dhënë në vlera monetare për ndërtimin e tij, duke i kërkuar të deklarojë në mënyrë kronologjike të gjitha shpenzimet/investimet e kryera për këtë objekt, që nga fillimi i ndërtimit deri në gjendjen aktuale, si edhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e tij, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: “[...] kësaj pyetjeje i është përgjigjur bashkëshorti [...]”.
146. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, trupi gjykues, pasi analizoi rrethanat dhe faktet mbi këtë pasuri, si dhe dokumentacionin e administruar në dosje, arrin në përfundimin se subjekti nuk zotëron pjesë takuese mbi këtë objekt dhe se nuk ka dyshime se ajo mund të ketë kontribut në krijimin e kësaj pasurie.

8. Pasuria apartament, me sip. 190 m², në Shëngjin

147. Në raportin e ILDKPKI-së⁵¹, bazuar në informacionin e marrë nga agjencitë ligjzbatuese është evidentuar se në datën 3.2.2011, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka porositur nga shoqëria “S. C.” sh.p.k. një pasuri të llojit apartament, në Shëngjin. Nga shqyrtimi i DIPP-së së viteve 2011, 2012 dhe 2013, si dhe në deklaratën *Vetting*, nuk ka rezultuar që kjo pasuri e porositur të jetë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit apo bashkëshorti i saj.
148. Bazuar në kërkesën e dërguar nga Komisioni⁵², ILDKPKI-ja⁵³ ka dërguar dokumentacionin e administruar ndër vite në dosjen e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. K. Dh., në të cilën rezulton të jetë bashkëlidhur deklarata e vitit 2013, ku ndodhen: (i) kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 3.2.2011, ndërmjet bashkëshortit të subjektit K. Dh. dhe shoqërisë “S. C.” sh.p.k.; (ii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 19.10.2013, “Për prishje kontrate”; (iii) kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 19.10.2013, lidhur midis shtetasit E. Dh. dhe shoqërisë “S. C.” sh.p.k.
149. Nga shqyrtimi i kontratës së sipërmarrjes⁵⁴ të datës 3.2.2011, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka porositur pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe të përgjithshme 109 m², në objektin që do të ndërtonte kjo shoqëri, në Sh., Lezhë, për çmimin 60,000 euro. Në këtë kontratë është referuar plani i pagesave si vijon: (i) kësti i parë në shumën 50,000 euro, i cili është likuiduar paraprakisht; dhe (ii) diferenca e mbetur do të paguhet me përfundimin e objektit.

⁴⁸Dokumentacioni shoqëruar i deklaratës *Vetting*, ndodhur në Aneks 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁹ASHK-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2020, ka informuar se në emër të subjektit Klorinda Çela dhe nënës së saj janë të regjistruara pasuritë e paluajtshme me nr. ***, vol. ***, f. ***, lloji *arë*, z. k. *** dhe pasuria e llojit *arë*, z. k. ***, nr. ***, të cilat janë përfituar nga nënshkrimi i kontratës së shitjes nr. ***, datë 13.3.2019; aktmarrëveshje e datës 9.2.1999; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 20.12.2019.

⁵⁰ASHK-ja ka konfirmuar se z. V. Dh. rezulton aplikues për legalizim të ndërtimit pa leje sipas formularit A, nr. *** prot., për të cilin është pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 26.4.2017. Pas procedurave të legalizimit duket se në datën 13.2.2020 është regjistruar në emër të z. V. Dh., pasuria e llojit ndërtesë me sip. 53 m², me shënimin te Seksioni i Hipotekave, Vendimeve të Gjykatës, Kufizimeve etj., “kufizim veprimesh deri në kryerjen e pagesave për parcelën ndërtimore pranë ASHK-së”.

⁵¹Raporti nr. ***, datë 6.9.2018, i ILDKPKI-së.

⁵²Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2021.

⁵³Shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021.

⁵⁴Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 3.2.2011, redaktuar nga noteri publik, z. V. M..

150. Subjekti i rivlerësimit, e pyetur nga Komisioni lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie, si dhe mbi burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë në shumën 50,000 euro, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, është shprehur se: “[...] kësaj pyetjeje i është përgjigjur në deklarimin e tij bashkëshorti dhe se kjo pronë është në pronësi të shtetasit E. Dh. dhe se ai mund të tregojë burimin e ligjshëm pasi ka 20 vjet në emigracion [...]”.
151. Nga shqyrtimi i deklaratës noteriale⁵⁵ “Për prishje kontrate” të datës 19.10.2013 ka rezultuar se shoqëria “S. C.” sh.p.k. dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kanë deklaruar se në datën 3.2.2011 kanë nënshkruar kontratën e sipërmarrjes për porositjen e ndërimit të apartamentit në objektin që kjo shoqëri po ndërton në Sh., Lezhë, dhe z. K Dh ka deklaruar se ky apartament është porositur prej tij formalisht në mungesë të vëllait të tij, i cili ishte emigrant me dokumente në Greqi dhe në kohën e përpilimit dhe nënshkrimit të kontratës nuk kishte mundësi të ishte prezent në nënshkrimin e saj.
152. Nga vlerësimi dhe shqyrtimi i kontratës evidentohet se kjo kontratë është nënshkruar prej z. K. Dh., por edhe nga shoqëria “S. C.” sh.p.k., e cila në kohën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes është vënë në dijeni, që me të ardhur në Shqipëri vëllai i tij, do të bëjnë revokimin e kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 3.2.2011, dhe do ta lidhin me vëllain e tij dhe të gjitha të drejtat e fituara nga z. K. Dh., sipas kontratës së mësipërme do t’i kalojnë vëllait të tij në kontratën e re që palët do të nënshkruajnë.
153. Gjithashtu nga shoqëria do të njihen të gjitha pagesat e kryera deri në këtë moment dhe nuk ndryshon asgjë nga kushtet e kontratës me z. K. Dh. me kontratën e z. E. Dh.⁵⁶. Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS rezultoi se shtetasi E. Dh. ka qenë në territorin shqiptar në datën e nënshkrimit të kontratës sipërmarrjes mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “S. C.” sh.p.k.⁵⁷.
154. Në kushtet kur duket se kjo pasuri është porositur dhe paguar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, me qëllim kryerjen e një hetimi shterues – Komisioni ka kryer analizën financiare për të evidentuar mundësinë e tyre, për kryerjen në datën 3.2.2011 të pagesës së këstit të parë për porositjen e kësaj pasurie, të pasqyruar në tabelën vijuese.

Tabela nr. 5

| Analiza financiare, periudha 1.1.2011 - 3.2.2011 | Vlerat në lekë |
|---|-----------------------|
| Apartamenti në Sh., paguar kësti i parë 50,000 euro | -6 915 000 |
| Ndryshim likuiditeti | -157 936 |
| Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit | 137 222 |
| Të ardhura nga paga e bashkëshortit | 158 606 |
| Shpenzime jetike | -38 179 |
| Shpenzime për kredinë në “Tirana Bank” | -34 160 |
| Shpenzime për kredinë në “Raiffeisen Bank” | -128 323 |
| Rezultati | - 6 977 770 |

⁵⁵Deklaratë noteriale “Për prishje kontrate” nr. ***, datë 19.10.2013, redaktuar nga noteri publik, z. V. M..

⁵⁶Ai deklaroi se heq dorë nga çdo e drejtë pronësie dhe pretendim ndaj pasurisë apartament me sip. 109 m² e ndodhur në katin e tetë, shkalla ***, apartamenti ***, në objektin që shoqëria “S. C.” sh.p.k. ka ndërtuar në Shëngjin. Kjo shoqëri ka deklaruar se heq dorë nga kontrata e parë e sipërmarrjes, cituar më sipër dhe gjithë pagesat e saj i kalon për llogari të kontratës që do të nënshkruajnë me shtetasin E. Dh. dhe këtë kontratë do ta nënshkruajnë po sot.

⁵⁷Për më tepër, Komisioni evidentoi se në datën 4.3.2011, z. E. Dh. ka depozituar *cash* në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, shumën prej 128,400 lekësh, me përshkrimin “E. Dh. derdh këst kredie”. Kjo sa i takon periudhës për të cilën sistemi TIMS disponon të dhëna. Në referim të të dhënave të sistemit TIMS, dalja e parë këtij shtetasi jashtë territorit shqiptar është në datën 25.5.2011.

155. Nga sa më sipër ka rezultuar, Komisioni konstaton se në kundërshtim me parashikimet e bëra në germën “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti nuk ka deklaruar këtë pasuri të paluajtshme dhe të drejtat reale mbi të as në deklaratat e interesave private periodike vjetore dhe as në deklaratën *Vetting*, të dorëzuara në ILDKPKI.
156. Nga analiza e kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, në kuptim të ligjit për deklarimin e pasurive dhe ligjit për konfliktin e interesave, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 porositjen e kësaj pasurie dhe të drejtat reale mbi të, pagesën e kryer gjatë këtij viti si shpenzim, burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e kryer, si edhe subjektin me të cilin ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale, duke u munduar ta fshehtë këtë pasuri dhe interesat private që e lidhin me të.
157. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të dhënë argumente/shpjegime dhe prova në lidhje me konstatimin e mësipërm. Rezulton se subjekti nuk depozitoi prova për të kundërshtuar rezultatin e hetimit, por ka sqaruar se vëllai i bashkëshortit ka qenë disa vite emigrant në disa shtete dhe me të ardhurat e krijuara dhe të akumuluar, ndër vite, ka qenë pronar i vetëm i kësaj pasurie.

Vlerësimi i trupit gjykues

158. Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se nuk qëndrojnë pretendimet e subjektit lidhur me faktin se e ka prenotuar pasurinë objekt vlerësimi në emër të vëllait të bashkëshortit të saj, për shkak se ai ndodhej jashtë shtetit. Subjekti, jo vetëm gjatë hetimit administrativ, por edhe pas dërgimit të rezultateve, nuk dha shpjegime/argumente sqaruese, si dhe nuk paraqiti dokumentacion ligjor për të provuar edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për kryerjen e pagesës së kësaj pasurie në datën 3.2.2011.
159. Trupi gjykues arrin në përfundimin se apartamenti me sip. 190 m², ndodhur në Sh., Lezhë, është pasuri e porositur dhe e paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, me qëllim përdorimin, disponimin dhe gëzimin e plotë nga ana e tyre, por, në vijim, kanë transferuar të drejtat e kësaj pasurie tek i vëllai i bashkëshortit, z. E. Dh., të cilat duken se janë kryer me qëllim shmangien e kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së burimeve financiare, që kanë shërbyer për pagesën/pagesat e kryera.
160. Nisur nga sa më sipër është evidentuar, trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe fakteve të mësipërme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë dhe, si rrjedhojë, gjendet në kushtet e germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
161. Komisioni, në vlerësim të rrethanave dhe fakteve të konstatuara dhe duke marrë në konsideratë faktin se si gjatë hetimit administrativ, por edhe gjatë dërgimit të rezultateve subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kësaj pasurie të parë për prenotimin e pasurisë në fjalë, pasi ka rezultuar një mungesë të mjeteve financiare prej 6,977,770 lekësh, në vitin 2011, duke u gjendur edhe në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

9. Njësi tregtare me sip. 124 m², në rrugën “D. B.”, Tiranë

162. Ka rezultuar se nga shqyrtimi i DIPP-së për vitin 2010, në seksionin “ndryshime të interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar kredi në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 10,000,000 lekë, por pa deklaruar qëllimin e marrjes dhe destinacionin e

vlerave monetare të përfituara prej saj. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2011, ka deklaruar pagesë kredie si dorëzanës, afërsisht në vlerën 1,500,000 lekë, ku në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” ka deklaruar pagesë kredie në “Raiffeisen Bank”, afërsisht shumën prej 15 milion lekë dhe gjendjen e detyrimit të mbetur afërsisht 9,5 milion lekë.

163. Konstatohet se në DIPP-të për vitet 2012 dhe 2013, subjekti nuk ka deklaruar të dhëna lidhur me këtë kredi, ndërsa në DIPP-në e vitit 2014, ka deklaruar: *“Gjendja e kredisë më 31.12.2014. Pagesa është bërë nga A. Ç. për llogari të të cilit është marrë edhe kredia, gjë e cila është sqaruar edhe në deklaratimet e mëparshme. Pagesa totale në shumën 1,612,603 lekë. Pagesa e interesave 669,429 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur është 5,706,207 lekë”*. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“[...] likuiduar nga shtetasi A. Ç. kredia e marrë prej tij duke çliruar nga dorëzania shtetasit K. Dh. dhe Klorinda Çela. Shuma e shlyer 5,743,640 lekë [...]”*.
164. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e ILDKPKI-së, lidhur me këtë marrëdhënie, ndër të tjera, është administruar⁵⁸ shkresa nr. *** prot., datë 3.1.2012, e shoqërisë “S.” sh.p.k. dhe dokumentacioni bashkëlidhur saj si: (i) ekstrakt bankar - nxjerrje llogarie në “Raiffeisen Bank” e shoqërisë “S.” sh.p.k.; (ii) kontratë porosie, datë 10.8.2009, lidhur midis shoqërisë “S.” sh.p.k., në cilësinë e palës së porositur dhe shtetasit A. Ç. në cilësinë e porositësit, si dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e garantuesit të kontratës; (iii) kontratë kredie bankare me nr. ***, datë 2.10.2010, në “Raiffeisen Bank”, me palë kredimarrëse subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin.
165. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁵⁹ ILDKPKI⁶⁰-ja ka dërguar dokumentacionin e administruar, ndër vite, në dosjen e subjektit deklarues z. K. Dh., nga verifikimi i të cilit ka rezultuar dokumenti me titull “sqarim”, drejtuar inspektorëve të ILDKPKI -së, me shënimin me shkrim të lirë dore “***”, në referim të së cilit, ndër të tjera, duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë parashtruar se: *“[...] në vitin 2010 është marrë një kredi në shumën 10,000,000 lekë nga ne si dorëzanës të shtetasit A. Ç.. Kjo për të paguar një ambient dyqan sipas kontratës së sipërmarrjes mes tij dhe shoqërisë ‘S.’ sh.p.k. Duam t’ju theksojmë se kjo kredi është marrë në emrin tonë për faktin se vetë subjekti A. Ç. (përkatësisht kunati dhe vëllai) nuk mund të merrte kredi sepse nuk plotësonte kushtet. Të gjitha pagesat e kësteve bëhen rregullisht nga ana e shtetasit A. Ç., në disa raste kur shtetasi A. Ç. ka vonuar një apo dy ditë pagesën, ajo është mbajtur nga llogaria e Klorinda Çela e cila është rikthyer menjëherë nga A. Ç.. Gjithashtu, në datën 2.4.2012 është bërë një parapagesë e një pjese të principalit të kredisë nga A. Ç. në shumën 2,400,000 lekë. Po e bëjmë këtë sqarim sepse nuk e kemi pasqyruar në deklaratimin e pasurisë për shkak të formatit të saj [...]”*.
166. Bashkëlidhur shkresës së dërguar nga ILDKPKI-ja, ndër të tjera, lidhur me marrëdhënien e sipërcituar evidentohet dokumentacioni si vijon: (i) kontratë porosie, datë 5.8.2009, lidhur midis shoqërisë “S.” sh.p.k., shtetasit A. Ç., në cilësinë e porositësit, dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e garantuesit të kontratës; (ii) mandatpagesë e subjektit “S.” sh.p.k., me nr. ***, datë 5.8.2009, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka paguar shumën 30,000 euro, me përshkrimin “për kontratën e datës 5.8.2009 ndërmjet palëve”.
167. Referuar kontratës së porosisë së datës 5.8.2009 konstatohet se z. A. Ç. ka porositur nga shoqëria “S.” sh.p.k., pasurinë e llojit dyqan me sip. 124 m², në objektin që kjo shoqëri po/do ndërtonte në rrugën “D. B.”, Tiranë, për çmimin 220,000 euro. Në këtë kontratë, subjekti i

⁵⁸Dokumentacioni ndodhur Aneks 40, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁹Shkresë nr. *** prot., datë 27.1.2021. Shënim: të gjitha dokumentet e dosjes së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit K. Dh., janë administruar nga trupi gjyqës, lutem referojuni dosjes së Komisionit.

⁶⁰Shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021.

rivlerësimit shfaqet si garantues i saj dhe plani i pagesave përcaktohet si vijon: (i) shuma 30,000 euro, në datën 5.8.2009; (ii) shuma 30,000 euro, në datën 25.10.2009; (iii) shuma 70,000 euro, në datën 25.3.2010; (iv) shuma 50,000 euro, në datën 25.10.2010; si dhe (v) shuma 20,000 euro, kur porositësit t'i jepet hipoteka.

168. Referuar kontratës së porosisë së datës 10.8.2009, konstatohet se z. A. Ç. ka porositur nga shoqëria "S." sh.p.k., pasurinë e llojit dyqan me sip. 124 m², në objektin që kjo shoqëri po/do ndërtonte në rrugën "D. B.", Tiranë, për çmimin 150,000 euro. Në këtë kontratë, subjekti i rivlerësimit shfaqet si garantues i saj, ndërsa plani i pagesa përcaktohet si vijon: (i) shuma 30,000 euro, në datën 5.8.2009; (ii) shuma 30,000 euro, në datën 25.10.2009; (iii) shuma 30,000 euro, në datën 25.3.2010; (iv) shuma 50,000 euro, në datën 25.10.2010; si dhe (v) shumën 10,000 euro, kur porositësit t'i jepet hipoteka⁶¹.
169. Shoqëria "S." sh.p.k. përfaqësuar nga administratori P. K., me shkresën e datës 3.1.2012 drejtuar ILDKPKI-së⁶², ka informuar se nuk ka marrëveshje kontraktuale me subjektin Klorinda Dhima (Çela) dhe z. K. Dh. dhe se marrëveshja kontraktuale që ata kanë është kontrata e porosisë e datës 10.8.2009 me z. A. Ç. (kunatin e z. K. Dh.), për blerjen e një dyqani në vlerën prej 150,000 euro. Në këtë kontratë, z. K. Dh., për shkak të njohjeve personale të mëparshme, është quajtur "garantues i kontratës"⁶³. Subjekti dhe bashkëshorti, mbi kolateralin e vendosur, kanë marrë kredi bankare sipas kontratës së datës 2.10.2010, në vlerën 10,500,000 lekë, nga e cila u kalua me transfertë bankare në favor të shoqërisë "S." sh.p.k., në "Raiffeisen Bank", shuma prej 7,800,000 lekësh, në datën 11.10.2010. Shuma e likuiduar deri më sot prej tyre është 10,800,000 lekë (rreth 85,000 euro), duke pasur një detyrim ndaj shoqërisë prej 65,000 euro.
170. Në këtë shkresë është referuar një plan tjetër pagesash nga ai i përcaktuar në kontratën/kontratën e sipërmarrjes, e cila paraqet të dhëna kontradiktore në përmbajtjen e saj, pasi nga njëra anë janë referuar tri pagesa të kryera në rrugë bankare nga shtetasi A. Ç., në total, shumat 3,000,000 lekë dhe 5,000 euro dhe një pagesë nga llogaria e kredisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në shumën 7,800,000 lekë, nga ana tjetër thuhet se pagesa totale e kryer është në shumën 10,800,000 lekë. Gjithashtu, nuk është referuar pagesa e kështit të parë në shumën 30,000 euro, në datën 5.8.2009, e cila sipas mandatpagesës është paguar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.
171. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pasi është pyetur nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, subjekti është shprehur se: "[...] ne nuk kemi bërë asnjë pagesë kredie në 'Raiffeisen Bank'. Ne kemi qenë dorëzanës për llogari të vëllait tim A. Ç. dhe pagesat i ka kryer ai vetë lidhur me kredinë e marrë për blerjen e një ambienti shërbimi. Pasuria për të cilën është marrë kredi nga vëllai është në pronësi të vëllait tim A. Ç.. Ne nuk kemi marrë asnjë kredi lidhur

⁶¹Duket se kemi 2 kontrata porosie – për të njëjtin objekt, me të njëjtat palë, të nënshkuara në dy data të ndryshme, në të cilat ndryshon çmimi dhe plani pagesave. Por, në të dy kontratat është përcaktuar se palët mund të bien dakord për ndryshimin e afateve të pagesave të kësteve të përcaktuara në kontratë, por ndryshimet nuk mund të jenë më të mëdha se një periudhë prej një muaji. Afatet e ndryshuara duhet të dokumentohen dhe të nënshkruhen nga të dyja palët, në të kundërt, ato janë të pavlefshme; Porositësi është i detyruar të paguajë këstet brenda afatit të përcaktuar në kontratë, në të kundërt ai detyrohet të paguajë kamat-vonesë në shumën prej 10 euro për çdo ditë përtej afatit të caktuar. Në rast se vonesa në kryerjen e pagesës së kështit zgjatet më shumë se një muaj, shuma e kamatëvonesës bëhet 20 euro për çdo ditë përtej afatit të caktuar. Në rast se Porositësi nuk kryen pagesën e kështit dhe kamatëvonesat përkatëse brenda dy muajve nga data e përcaktuar në kontratë, kjo kontratë konsiderohet e zgjidhur automatikisht, pa qenë e nevojshme që Porositësi të paralajmërohet ose të njoftohet në çdo lloj forme (neni 4 i kontratës); dhe Në rast se porositësi, z. A. Ç., nuk respekton detyrimet e shkruara në këtë kontratë, atëherë të gjitha ato kalojnë në mënyrë automatike tek Garantuesi i kësaj kontrate, z. K. Dh., i cili merr përsipër pa asnjë imponim dhe me vetëdije të plotë të gjitha detyrimet ekonomike dhe sanksionet e cituara në kontratë (neni 13 i kontratës).

⁶²Protokolluar në ILDKPKI me nr. *** prot., datë 5.1.2012.

⁶³Kjo zgjidhje u bë prej tij për shkak të pasigurisë që i paraqiti A. Ç. në likuidimin e kësteve të parashikuara në këtë kontratë. Në vijim të likuidimit të detyrimeve z. A. Ç. ka paguar në rrugë bankare shumat: 2,000,000 lekë në datën 30.10.2009; 5,000 euro në datën 7.1.2010; dhe 1,000,000 lekë në datën 5.5.2010.

me blerjen e ndonjë njësie shërbimi. Ne kemi qenë vetëm dorëzanës dhe nuk kemi menduar se kjo dorëzani duhej deklaruar, pasi sipas Kodit Civil dorëzania lind detyrime në momentin kur kredimarrësi nuk paguan detyrimin. Të gjitha pagesat janë kryer nga A. Ç.. Pasuria është në emër të shtetasit A. Ç.. Kontrata e huas midis shtetasit A. Ç. dhe 'Raiffeisen Bank' e vërteton këtë. Në ASHK-në Tiranë ndodhet i gjithë dokumentacioni lidhur me këtë pasuri, pasi ne nuk mund të marrim dokumentacion që i përket dikujt tjetër bazuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale [...]”.

172. Komisioni kreu analizën financiare për të evidentuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për kryerjen në datën 5.8.2009 të pagesës së kështit të parë për porositjen e pasurisë objekt vlerësimi, të detajuar në tabelën në vijim:

Tabela nr. 7

| Analiza financiare për periudhën 1.1.2009 – 5.8.2009 | Vlerat në lekë |
|--|-------------------|
| Të ardhura nga paga bashkëshorti i subjektit | 552 253 |
| Të ardhura nga mësimdhënia, bashkëshorti i subjektit | 266 040 |
| Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit | 530 394 |
| Të ardhura nga mësimdhënia, subjekti i rivlerësimit | 86 400 |
| Njësi tregtare me sip. 124 m ² , kësti i parë 30,000 euro | -4 115 100 |
| Ndryshim likuiditeti | -101 182 |
| Shpenzime jetike | -241 424 |
| Shpenzime për kredinë në “Tirana Bank” | -216 317 |
| Rezultati | -3 036 573 |

173. Nga sa më sipër, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kështit të parë për prenotimin e kësaj pasurie, duke i kaluar barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe prova lidhur me sa më sipër.
174. “Raiffeisen Bank”⁶⁴ ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një kredi në shumën 10,500,000 lekë, të marrë në datën 8.6.2010 dhe të mbyllur më 15.5.2015, ku në deklaratën e bërë nga subjekti, burimi i të ardhurave për mbylljen e kredisë ka qenë nga kursimet familjare. Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga “Raiffeisen Bank”, ka rezultuar se më 2.10.2010, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti – në cilësinë e bashkëkredimarrësve, kanë nënshkruar kontratën e kredisë bankare dhe hipotekore⁶⁵ me “Raiffeisen Bank”, duke përfutur kredinë konsumatore prej 10,500,000 lekësh. Ndërsa, në cilësinë e dorëzanësve hipotekorë në këtë kredi janë shtetasit P. K. dhe M. K. dhe si kolateral për marrjen e kësaj kredie është vendosur pasuria e llojit apartament me sip. 134 m², e ndodhur në rrugën “M. D.”, Tiranë.
175. Bazuar në kërkesën⁶⁶ e bërë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, është ndryshuar pasuria e lënë si garanci për këtë kredi, duke u vendosur si kolateral pasuria e llojit “njësi” me sip. 123.9 m², në rrugën “D. B.”, Tiranë, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me nr. pasurie ***, e cila duket se është e njëjtë me pasurinë objekt vlerësimi⁶⁷. Rezulton se në datën 8.10.2010

⁶⁴Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2020.

⁶⁵Kontratë kredie bankare dhe hipotekore nr. ***, datë 2.10.2010, redaktuar nga noteri publik, M. K..

⁶⁶Kërkesa e datës 19.2.2013 - pjesë e dosjes së kredisë.

⁶⁷Gjithashtu, aplikimi i bërë për bllokimin e pasurisë në hipotekë është bërë nga shtetasi A. Ç., të cilit i është konfirmuar zyrtarisht nga ZVRPP Tiranë bllokimi i kësaj pasurie të paluajtshme. Po ashtu, konstatohet se megjithëse kemi të bëjmë me

është disbursuar në llogarinë bankare të subjektit, znj. Klorinda Çela, shuma prej 10,500,000 lekësh.

176. Në vijim, në datën 11.10.2010, nga kjo llogari znj. Klorinda Çela transferon shumën prej 7,800,000 lekësh në favor të shoqërisë “S.” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë detyrimi”, ndërsa pjesa tjetër prej 2,198,000 lekësh tërhiqet *cash* brenda të njëjtës ditë. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, kjo kredi është shlyer para kohe deri në datën 15.5.2015, paguar nga llogaria e pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank”⁶⁸, shuma në total përfshirë principal, interes dhe sigurime jete dhe prone, në vlerën 15,128,979 lekë.
177. Gjatë viteve 2011 – 2015 janë depozituar *cash* dhe janë transferuar në këtë llogari nga persona të tretë vlera monetare për shlyerjen e kësteve të kredisë, konkretisht, nga shtetasit: (i) E. Dh. shumën prej 128,400 lekësh; (ii) B. S. shumën prej 691,000 lekësh; (iii), F. E. shumën prej 309,000 lekësh; (iv) A. Ç. shumën 10,968,640 lekësh; si dhe (v) H. B. shumën prej 160,000 lekësh. Gjithashtu, rezulton se disa pagesa këstesh janë mbajtur nga paga e subjektit të rivlerësimit nga llogaria e saj e kursimit, si edhe janë kryer prej saj depozitime *cash* në këtë llogari.
178. Sa më sipër, në kushtet kur fondet e depozituara apo të transferuara nga shtetasit e sipërcituar kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga subjekti dhe bashkëshorti, në referim të pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, shtetasit E. Dh., B. S., F. E., A.C. dhe H. B., bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast, të provojnë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të depozituara apo të transferuara në llogarinë bankare të personit të lidhur. Për rrjedhojë, në analizën paraprake financiare, e gjithë vlera e kredisë së shlyer sipas informacionit të “Raiffeisen Bank”, është reflektuar si shumë e paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur.
179. Nga sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar identitetin e shtetasve, të cilët kanë kryer këto depozitime në llogarinë e përbashkët me bashkëshortin, qëllimin e tyre, marrëdhënien mbi bazën e së cilës ato janë kryer, si dhe paraqitjen e dokumentacionit ligjor dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të këtyre shtetasve, për të justifikuar shumat e depozituara/transferuara në këtë llogari.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

180. Në prapësimet e depozituara, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrimin se ajo dhe bashkëshorti i saj kanë paraqitur të gjithë dokumentacionin ligjor dhe aktet noteriale së bashku me deklaratën *Vetting*. Ndërkohë, lidhur me dorëzaninë, subjekti ka bërë me dije se në deklaratimet periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar se së bashku me bashkëshortin kanë lidhur me “Raiffeisen Bank”, një kontratë dorëzanie për kredimarrësin A. Ç. dhe nuk e kupton pse anashkalohe ky fakt. Kredia e marrë është paguar tashmë nga shtetasi A. Ç., është marrë për pagesën e vlerës së ambientit të shërbimit, i cili edhe sot e kësaj dite është i reregjistruar prej tij, që e zotëron dhe e gëzon lirisht. Qenia dorëzanës në një kontratë kredie nuk të bën automatikisht kredimarrës, por vetëm në momentin që kredimarrësi nuk paguan kredinë, është krejtësisht normale që dikush të dalë dorëzanë për vëllanë.

një kredi konsumatore, pjesë e dokumentacionit të dosjes së kësaj kredie gjendet dhe kontrata e porosisë e datës 5.8.2009, nënshkruar mes shoqërisë “S.” sh.p.k. dhe A. Ç. – si porositës, si dhe K. Dh. – garantues, për porositjen e njësisë së shërbimit me sip. 124 m², për çmimin prej 220,000 euro.

⁶⁸Shkresë nr. *** prot., datë 25.5.2021.

181. Ndërsa lidhur me identitetin e personave që kanë kryer depozitimet në llogari, subjekti u shpreh se ka njohje me disa prej tyre, duke dhënë edhe shpjegime⁶⁹, si dhe pohoi faktin se me këta shtetas së bashku me bashkëshortin nuk kanë zhvilluar gjykime.

Vlerësimi i trupit gjykues

182. Në kushtet kur edhe me dërgimin e rezultateve subjekti nuk dërgoi prapësimet e saj, pra, nuk paraqiti shpjegime shteruese, si dhe nuk depozitoi prova për të kundërshtuar rezultatin e arritur gjatë hetimit, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti rivlerësimi dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e këstit të parë për likuidimin e çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, qoftë edhe në përmbushje të detyrimit si garantues.

183. Për më tepër, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti nuk ka deklaruar, ndër vite, hua/të apo dhurime/et që lidhen me këto depozitime apo transferta nga shtetasit e lartpërmendur të cilët nuk kanë konfirmuar marrëdhënien hua/së apo dhurimi, si edhe nuk është/janë depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar burimin e ligjshëm për të ardhurat e tyre, trupi gjykues vlerëson se gjithë vlera e kredisë së shlyer reflektohet si shumë e paguar nga subjekti i rivlerësimi dhe personi i lidhur me të.

184. Në vijim të verifikimeve dhe hetimeve të kryera lidhur me këtë pasuri, Komisioni vëren se “Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë” (UKT)⁷⁰ informon se në emër të subjektit të rivlerësimi figuron kontratë furnizimi aktive me nr. ***, me datë hapje 6.4.2011, në adresën rruga “****”, pallati “*****” sh.p.k., Tiranë⁷¹, e cila përkon me adresën e pasurisë, njësisë tregtare objekt vlerësimi, por se disponojnë vetëm një libër faturimi ku shënohen me shkrim dore disa të dhëna.

185. Pasi Komisioni kërkoi⁷² dokumentacionin, mbi bazën e të cilit është lidhur kjo kontratë furnizimi me ujë të pijshëm, UKT-ja⁷³ informon se për kontratën nr. *** disponon vetëm libër faturimi. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni, për këtë kontratë është dërguar kopje e dokumentit me titull “regjistër kontraktuesve”, nga ku rezulton se janë pasqyruar me shkrim të lirë dore të dhënat, si vijojnë (në rreshtin e dytë të tabelës vijuese):

| Nr. rendor | Nr. Kontratës | Nr. Frymëve | Adresa | Ndryshime | | Nr. Frymëve | Shënime |
|------------|---------------|-------------|--------|---------------|------|-------------|---------|
| | | | | Emri, Mbiemri | Data | | |
| 1 | *** | D | K. D. | Rr. “****” | | | S. D2 |

⁶⁹Shtetasi A. M., siç dhe është deklaruar, ka qenë dhe mbetet mik i familjes sonë, ai ka qenë president i kompanisë “K.” dhe shtetasi E. Z. (i cili nuk jeton më), gjithashtu, mik i familjes i cili ka punuar se bashku me bashkëshortin tim K. Dh. pranë universitetit “K.”. Shtetasi R. H. ka qenë jo dhurues por përfaqësues në dijeninë time në marrëdhënien me bashkëshortin tim. Shtetasi F. E., i cili ka qenë mik me bashkëshortin tim ka bërë, herë pas here, pagesën e këstit të kredisë në llogarinë tonë dhe nuk kemi pasur kurrë gjykime me këtë person. Shtetasit e tjerë M. Ç., E. M., F. M., H. M. janë punonjës të siguruar të kompanisë së nënës sime M. Ç., ku ka qenë pjesëtar i kësaj kompanie edhe vëllai im A. Ç., të cilit i kam kërkuar të paguante këstin e kredisë dhe që ky i fundit ua ka deleguar punonjësve të tjerë. Këta persona nuk i njoh fare dhe nuk kam bërë kurrë gjykim në çështje ku ata kanë qenë palë. Kurse shtetasit B. S. dhe H. B., të cilët as nuk i njoh, sipas bashkëshortit tim, kanë qenë punonjës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër si shofere dhe ftues dhe kane paguar këstet e kredisë, pasi u është kërkuar nga bashkëshorti im në kohën kur ka punuar si gjyqtar pranë kësaj gjykate. Bashkëlidhur edhe vërtetimi, datë 14.10.2021, nga shoqëria *** Albania, për punësimin e shtetasve në këtë shoqëri.

⁷⁰Shkresë, datë 3.4.2020.

⁷¹Referuar të dhënave nga SMI (sistemi i menaxhimit të informacionit) të UKT-së.

⁷²Shkresa nr. *** prot., datë 31.5.2021.

⁷³Shkresa nr. *** prot., datë 18.6.2021.

186. Gjithashtu, Komisioni konstaton se në funksion të verifikimit të kësaj pasurie, ILDKPKI-ja i ka kërkuar z. A. Ç., që në cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, të plotësojë deklaratën e interesave private. Fillimisht, z. A. Ç., ka refuzuar plotësimin e kësaj deklarate dhe, si rrjedhojë, në datën 7.2.2013, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së ka nxjerrë vendimin⁷⁴ për vendosjen e gjobës për mosdeklarim të interesave private me kërkesë, vendim i përcjellë me shkresën⁷⁵ e datës 11.2.2013.
187. Në datën 25.3.2013, z. A. Ç., ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e interesave private me kërkesë⁷⁶, ku, ndër të tjera, lidhur me pasurinë në fjalë në seksionin “deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit” ka deklaruar “dyqan me sip. 130 m², në bazë të kontratës së shitjes me shoqërinë ‘S.’ sh.p.k”. Në seksionin “detyrimet Financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka deklaruar: (a) “Kredi te ‘Raiffeisen Bank’ marrë në emër të shtetasve K. Dh. she Klorinda Çela si dorëzanës, shuma e detyrimit të mbetur 8,000,000 lekë”; (b) “Detyrim financiar te shoqëria ‘S.’ sh.p.k”. Në seksion të veçantë ka deklaruar: “K. Dh. e Klorinda Çela, përkatësisht kunati dhe motra ime janë garant të kontratës së sipërmarrjes dhe kanë marrë kredi në llogarinë time”.
188. Komisioni konstaton se në këtë deklaram shtetasi z. A. Ç., nuk ka deklaruar të dhëna mbi kontratën e porosisë së nënshkruar me shoqërinë “S.” sh.p.k., çmimin e kësaj pasurie, pagesat e kryera, burimin e ligjshëm të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për kryerjen e pagesave, detyrimin e mbetur, nëse ka.
189. Sa më sipër, në analizë të të gjitha provave të administruara në dosje dhe *indicieve* të evidentuara lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, si mandatpagesa e datës 5.8.2009, sipas së cilës bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paguar shumën prej 30,000 euro në favor të shoqërisë ndërtuese, rezulton:
- i. mosevidentimi nga shoqëria ndërtuese i pagesës së kryer në datën 5.8.2009 nga bashkëshorti i subjekti dhe informacionit kontradiktor për pagesat e kryera;
 - ii. ekzistenca e dy kontratave porosie me të njëjtët palë, të njëjtin objekt, me çmim të ndryshëm dhe, si rrjedhojë, edhe ndryshim të planit të pagesave;
 - iii. aplikimi dhe përfitimi në vitin 2010 i kredisë konsumatore nga subjekti dhe personi i lidhur në “Raiffeisen Bank”, në shumën prej 10,500,000 lekësh⁷⁷;
 - iv. mosdeklarimi në DIPP-të përkatëse i qëllimit të marrjes dhe destinacionin e vlerave monetare të kësaj kredie;
 - v. fakti që bashkëshorti i subjektit, shfaqet si garantues i kontratës së porosisë, si dhe deklarimi mbi miqësinë e tij me ortakun e vetëm të shoqërisë “S.” sh.p.k.;
 - vi. vënia si kolateral për kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit i pasurive në pronësi të shoqërisë “S.” sh.p.k., regjistrimi në emër të bashkëshortit të subjektit të kontratës për furnizim me ujë për pasurinë e ndërtuar nga shoqëria “S.” sh.p.k.;
 - vii. mosdeklarimi i burimit të krijimit të shumave të cilat duket se janë depozituar apo transferuar nga z. A. Ç., në llogarinë e subjektit për shlyerjen e kredisë, si dhe evidentimi i kreditimeve të tjera të kryera nga persona të tretë në këtë llogari – me qëllim shlyerjen e kredisë;
 - viii. refuzimi fillestar për deklarimin e pasurive, mosdeklarimi i burimit të krijimit, si edhe deklarimi i disa rrethanave jo të sakta lidhur me të, nga z. A. Ç..

⁷⁴Vendim nr. ***, datë 7.2.2013, ndodhur Ankes ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁵Shkresa nr. *** prot., datë 11.2.2013, ndodhur Ankes ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁶Referuar vërtetimit kjo deklaratë është dorëzuar nga shtetasi F. E.. Vërtetimi i dorëzimit dhe deklarata, ndodhur Aneks 40, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

⁷⁷Nga ku shuma prej 7,800,000 lekësh është transferuar në favor të shoqërisë “S.” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë detyrimi”.

190. Nisur nga sa më sipër është listuar dhe përshkruar, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme se kjo pasuri *de facto* është porositur dhe paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur - me qëllim përdorimin, disponimin dhe gëzimin e plotë prej tyre, por se kontrata e porosisë *de jure* është lidhur në emër të z. A. Ç., në përpjekje për fshehjen e kësaj pasurie – në dukje me qëllim shmangien e kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së burimeve të cilat kanë shërbyer për pagesën/pagesat e kryer/a për likuidimin e çmimit të blerjes së saj.
191. Nga analiza paraprake e dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këtë pasuri, çmimi për blerjen e saj është në vlerën prej 220,000 euro, ndërsa sipas kontratës së porosisë të datës 5.8.2009, nisur nga evidentimi i pagesës në shumën prej 30,000 euro të kryer në këtë datë dhe faktit se është pikërisht kjo kontratë e cila është depozituar në dosjen e kredisë në “Raiffeisen Bank” dhe për sa kohë nuk është provuar revokimi i saj, si dhe në referim të parashikimeve të kontratës së porosisë dhe në kushtet kur nuk dokumentohet ndryshimi i afateve të pagesave të kësteve, pagesat duhet të jenë kryer sipas përcaktimeve të bëra në kontratë. Por, nga ana tjetër referuar shkresës së shoqërisë “S.” sh.p.k., dhe informacionit të marrë nga “Raiffeisen Bank”, disa pagesa të kryera nuk përputhen me datat e përcaktuara në kontratë.
192. Nisur nga sa më sipër, dy pagesat e vetme të evidentuara si të kryera në favor të shoqërisë “S.” sh.p.k., për të cilat disponohet dokumentacion provues, janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të. Kjo nisur edhe nga fakti se nuk ka evidenca të sakta të pagesave të tjera të kryera për likuidimin e çmimit prej 220,000 euro, në referim të parashikimeve të bëra në kontratën e porosisë, për vitin 2009 është paguar shuma prej 80,000 euro dhe për vitin 2010 është paguar shuma prej 120,000 euro.
193. Në këtë kuptim, në kushtet kur duket se kjo pasuri është porositur dhe është paguar nga bashkëshorti i subjekti i rivlerësimit, si edhe nisur nga parashikimet e bëra në kontratën e porosisë së datës 5.8.2009, Komisioni kreu analizën financiare për të evidentuar mundësinë e subjektit dhe personave të lidhur me të, për kryerjen e pagesave gjatë vitit 2009 dhe 2010, për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie.

Tabela nr. 8

| Analiza financiare për periudhën 1.1.2009 – 31.12.2009 | Vlerat në lekë |
|--|-----------------------|
| Të ardhura nga paga e subjektit | 788 146 |
| Të ardhura nga mësimdhënia e subjektit | 99 619 |
| Të ardhura nga paga bashkëshortit | 773 326 |
| Të ardhura nga mësimdhënia të bashkëshortit | 382 860 |
| Njësi tregtare me sip. 124 m ² , në rrugën “D* B*”. | -10 973 600 |
| Ndryshim likuiditeti | -86 539 |
| Shpenzime jetike | -409 860 |
| Shpenzime për kredinë pranë Tirana Bank | -373 788 |
| Shpenzime për udhëtime jashtë vendit | -601 490 |
| Shpenzime shëndetësore jashtë vendit | -1 097 360 |
| Rezultati | -11 498 687 |

Tabela nr. 9

| Analiza financiare për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2010 | Vlerat në lekë |
|---|-----------------------|
| Të ardhura nga paga e subjektit | 437 715 |
| Të ardhura nga paga, të bashkëshortit | 817 877 |
| Të ardhura nga mësimdhënia, të bashkëshortit | 819 180 |
| Kredi te 'Raiffeisen Bank' (blerje dyqani, te "S*" sh.p.k.) | 10 500 000 |
| Ndryshim likuiditeti | 765 486 |
| Shpenzime jetike | -409 860 |
| Shpenzime për kredinë pranë 'Tirana Bank', disbursuar në datën 22.8.2005 | -325 093 |
| Shpenzime për kredinë në 'Raiffeisen Bank', disbursuar në datën 8.10.2010 | -756 646 |
| Njësi tregtare me sip. 124 m ² , ndodhur në rrugën "D* B**" | -16 657 200 |
| Shpenzime për udhëtime jashtë vendit | -183 923 |
| Shpenzime shëndetësore jashtë vendit | -832 860 |
| Shpenzime të deklaruara nga subjekti me Western Union | -419 800 |
| Rezultati | -6 245 124 |

194. Nga sa më sipër, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesat e kryera gjatë viteve 2009 dhe 2010, për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.
195. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet dhe provat tuaja në lidhje me konstatimin e mësipërm. Nga shqyrtimi dhe depozitimi të prapësimeve të dërguara nga subjekti, ka rezultuar se subjekti nuk paraqiti shpjegime /argumente apo prova për të kundërshtuar rezultatin e arritur nga Komisioni.

Vlerësimi i trupit gjykues

196. Nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nëpërmjet prapësimeve, pasi është njohur me rezultatet e hetimit, nuk dha shpjegime dhe nuk paraqiti dokumentacion ligjor shtesë për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit, si përfundim, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar pagesat e kryera gjatë vitit 2009, ku rezulton një bilanc negativ prej 11,498,687 lekësh dhe gjatë vitit 2010, ku rezulton një bilanc negativ prej 6 245 124 lekësh dhe po gjatë vitit 2010 likuidimi i çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, sikurse nuk ka pasur burime të ligjshme as personi në emër të të cilit ishte regjistruar kjo njësi tregtare, e vlerësuar nga Komisioni si pasuri e fshehur prej saj dhe bashkëshortit të saj - duke u gjendur edhe në kushtet e germës "b", të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

10. Dhurime, hua, sponsorizime/ndihma financiare, shpërblime, të ardhura nga shitja e librave të botuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit

197. Nga verifikimi i DIPP-ve, ndër vite, të subjektit të rivlerësimit, si dhe i deklaratës *Vetting*, krahas dhurimeve dhe huave të trajtuara më lart, u evidentuan deklaratime të bëra për hua, dhurime, sponsorizime, ndihma financiare, si edhe të ardhura nga shitja e librave, të pasqyruara si vijon:

- i. **Dhuratë nga prindërit e subjektit në shumën 400,000 lekë**, në vitin 2007, për mobilim shtëpie, provuar kjo me deklaratë noteriale nr. ***, datë 19.10.2012. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se ka paraqitur dokumentacionin në ILDKPKI dhe se kjo shumë i është dhuruar nga familjarët jo nëpërmjet bankës.
- ii. **Hua në shumën 10,000 euro nga shtetasi E. Z.**⁷⁸, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si detyrim shumën 3,000 euro, të mbetur nga huaja e marrë në vitin 2012, pa afat dhe pa interes, jo nëpërmjet sistemit bankar. Qëllimi i huas ka qenë likuidimi i parakohshëm i një pjese të kredisë të marrë në “Tirana Bank”. Nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se nuk ka mundësi të japë shpjegime lidhur me burimin e këtyre fondeve nga huadhënësi, pasi ka qenë mik i bashkëshortit dhe është në dijeni se gjatë asaj periudhe ka qenë i punësuar në kompaninë “K.”.
- iii. **Hua në shumën 6,000 euro, nga shtetasi V. Dh.**⁷⁹, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar detyrim financiar në shumën 6,000 euro, hua e marrë prej babait të bashkëshortit në fillim të muajit janar të vitit 2012, pa afat dhe pa interes. Qëllimi i huas ka qenë likuidimi i parakohshëm i një pjese të kredisë së mbetur në “Tirana Bank”. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se vjehëri është pensionist dhe ka punuar si emigrant në Greqi, për vite me radhë, por nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion mbështetës për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të cilat kanë mundësuar dhënien e huas.
- iv. **Sponsorizime, shpërblime dhe dhurime nga shtetasi A. M., në shumën 64,300 euro.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: *“Sponsorizim nga shtetasi A. M., për periudhën 2008 – 2013, nga ish-presidenti i kompanisë ‘K.’ sh.p.k., kryesisht për punën e bashkëshortit si pedagog pranë universitetin ‘K.’, për shumë vjet, për kurimin e subjektit jashtë shtetit, si dhe për pushime jashtë vendit së bashku me familjen e tij. Këto pagesa nuk janë bërë nëpërmjet sistemit bankar apo nga arka e kompanisë. Kjo provohet nga vetë shtetasi, si dhe nga dy deklaratat noteriale të cilat konfirmojnë faktet e parashikuara më sipër”*. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, ndër vite, në ILDKPKI, janë deklaruar:
 - Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: (i) sponsorizim për pushime në Turqi dhe Egjipt nga A. M., në shumën 3,800 euro; (ii) sponsorizim për botim libri, në shumën 20,000 euro⁸⁰.

⁷⁸Referuar deklaratës së datës 10.1.2012 (shkresë e thjeshtë), bashkëshorti i ka marrë hua shtetasit E. Z. shumën prej 10,000 euro, pa interes dhe pa afat të caktuar shlyerje. Ndërsa me deklaratën e datës 20.12.2012 (shkresë e thjeshtë), bashkëshorti deklaroi se i ka shlyer në datën e deklarimit huadhënësit E. Z., shumën prej 7,000 euro dhe se pjesa tjetër e detyrimit do të shlyhet në një afat të pacaktuar. Të dyja deklaratat duket se janë nënshkruar edhe prej huadhënësit, E. Z.. Deklaratat janë depozituar nga subjekti në mbështetje të deklaratës *Vetting*, ndodhur Aneks 4/13, në dosjen e ILDKPKI. Gjithashtu, me deklaratën noteriale nr. ***, datë 29.10.2016, shtetasi E. Z. deklaroi se në datën 10.1.2012, i ka dhënë hua pa interes shtetasit K. Dh., shumën 10,000 euro. Nga kjo shumë brenda vitit i është likuiduar shuma 7,000 euro.

⁷⁹Referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 18.1.2017, ndodhur Aneks 4/15, në dosjen e ILDKPKI-së, z. V. Dh., ka deklaruar se i ka dhënë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në vitin 2012 hua pa interes, shumën prej 6,000 euro, për një afat të pacaktuar kohor.

⁸⁰Referuar dokumentit të thjeshtë me titull “Kontratë dhurimi”, datë 15.1.2008, shtetasi A. M., presidenti i universitetit “K.”, ka deklaruar se i dhuron pedagogut të këtij universiteti, z. K. Dh., bashkëshortit të subjektit shumën prej 20,000 euro. Me anë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 25.10.2016, shtetasi A. M. ka deklaruar se nga të ardhurat e fituara si rezultat i veprimtarisë tregtare të universitetit “K.”, datë 15.1.2008, i ka dhënë në formë shpërblimi/sponsorizimi shumën prej 20,000 euro, ka sponsorizuar për kurimin në Austri dhe, gjithashtu, shpenzimet e udhëtimeve familjare në vitin 2008 në shumën 3,800 euro, për udhëtimin në Turqi. Pyetur nga Komisioni lidhur me shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet e udhëtimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se ka dhënë shpjegime në deklarime vjetore si dhe ka paraqitur prova shkresore. Ndërsa për shtetasin A. M. ka shpjeguar se: *“Ai qenë dhe mbetet mik i ngushtë i familjes sonë (edhe pse tashmë i falimentuar). Në kohën e sponsorizimit prej tij ai ka qenë pronar i universitetit ‘K.’ dhe i disa bizneseve të tjera dhe burimi i sponsorizimit natyrisht kanë qenë të ardhurat e ligjshme nga bizneset”*. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 22.1.2017, shtetasi A. M. ka deklaruar se i ka dhënë subjektit të rivlerësimit dhurime për shpërblime dhe sponsorizime, për periudhën 2010 - 2013 në shumën 10,000 euro, 15,000 euro dhe 5,000 euro, të cilat nuk janë paguar nga arka e kompanisë por nga të ardhurat e tij

- Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: (i) sponsorizim për udhëtim turistik, në shumën 2,500 euro; (ii) sponsorizim për operacionin e bërë jashtë shtetit, në shumën 8,000 euro.
- Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar, dhuratë shumën 10,000 euro.
- Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar, dhuratë shumën 15,000 euro.
- Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar, shpërblim dhënë bashkëshortit, nga puna si pedagog prej universitetit “K.”, shumën prej 5,000 euro.

198. Sponsorizim në shumën 150,000 lekë nga shtetasi Xh. H., të deklaruar në deklaratën *Vetting*, për botim libri të bashkëshortit, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 24.10.2016. Në DIPP-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar sponsorizim për botim libri, shumën 150,000 lekë, por nuk ka deklaruar individin sponsorizues. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka specifikuar se: “[...] lidhur me sponsorizimet e bëra nga Xh. H. mesa di unë ai ka qenë biznesmen, pasi as unë e as bashkëshorti im nuk e kemi njohur personalisht në kohën e sponsorizimit, ai ka qenë i njohur me bashkautorin e librit të bërë nga bashkëshorti, z. D. A.. Referuar deklaratës noteriale të datës 24.10.2016, shtetasi Xh. H. ka deklaruar se në vitin 2004 i ka dhënë në formën e sponsorizimit shtetasit D. A. me detyrë aktuale gjyqtar, shumën prej 150,000 lekë, për botimin e librit *Fjalor italisht-shqip-itallisht* [...]”.
199. Nga sa më sipër, ka rezultuar se ka mospërputhje në deklarimet e subjektit, pasi në referim të deklaratës noteriale konstatohet se sponsorizimi në shumën prej 150,000 lekësh është kryer në favor të shtetasit D. A. dhe se kjo shumë është sponsorizuar në vitin 2004 dhe jo në vitin 2005, kur duket se është deklaruar për herë të parë nga subjekti.
200. Nga verifikimi në DIPP-të, ndër vite, nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI rezulton se subjekti nga shitja e librave të bashkëshortit⁸¹ në total, për vitet 2005 – 2013, ka deklaruar se ka përfituar të ardhura në shumën prej 3,360,000 lekësh. Lidhur me këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar përfitimin e këtyre të ardhurave të deklaruara ndër vite dhe as për pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e pretenduara.
201. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar mbi burimin e krijimit të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, por nuk ka depozituar dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e shtetasve që pretendohet se kanë shërbyer për dhënien e huave, dhurimeve, shpërblimeve apo sponsorizimeve të evidentuara⁸².
202. Sa më sipër, në referim të pikës 14, të nenit 3 dhe të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, shtetasit M. Ç., E. Z., V. Dh., A. M. dhe Xh. H. bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojnë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për

monetare personale. Referuar deklaratës së thjeshtë drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të datës 30.4.2014, shtetasi A. M. ka konfirmuar (pa dhënë vlera në shifra), se ka sponsorizuar tri udhëtime në Turqi dhe për përgatitjen e librave të ndryshëm, por nuk i ka përballuar këto shpenzime nga llogaria e kompanisë por nga shpenzimet e veta.

⁸¹Për vitet dhe shumat si vijon, (i) për vitin 2005 shumën prej 100,000 lekë; (ii) për vitin 2007 shumën prej 910,000 lekë; (iii) për vitin 2008 shumën prej 750,000 lekë; (iv) për vitin 2009 shumën prej 800,000 lekë; (v) për vitin 2010 shumën prej 300,000 lekë; (vi) për vitin 2011 shumën prej 200,000 lekë, dhe (vi) për vitin 2012 shumën prej 300,000 lekë.

⁸²Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të bënte me dije mbi marrëdhënie të mundshme familjare/shoqërore apo të çfarëdolloj, duke përfshirë edhe konfliktin e mundshëm të interesave me shtetasit: A. M., E.Z., Xh. H., A. Ç., dhe shoqëria universiteti “K.”, shoqëria “B.”, sh.p.k., R. B., shoqëria “E.” sh.p.k., shoqëria “I.” sh.p.k., A.D., A. D., G. D., A. Zh., P. J., E. J., shoqëria “S. C.” sh.p.k., P. K., M. K., shoqëria “S.” sh.p.k, duke bashkëlidhur dokumentacionin provues përkatës, për të gjitha gjykata ku keni ushtruar funksionin dhe detyrën.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ajo ka shpjeguar se: “Lidhur me shtetasit e përmendur më lart, unë personalisht, nuk kam pasur asnjë proces gjyqësor me këto palë, bashkëshorti im ma konfirmon këtë gjë edhe për veten e saj mesa mban mend”. Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues.

krijimin e shumave të pretenduara si të dhëna hua, dhuruara, apo të dhëna në formë shpërblimesh e sponsorizimesh.

203. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjekti të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet dhe provat në lidhje me konstatimin e mësipërm.
204. Në vijim, ashtu sikurse është evidentuar edhe më herët, në kushtet kur subjekti nuk paraqiti prapësimet, lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, sipas parashikimit të bërë në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në konkluzionin se këto vlera monetare të deklaruara si dhurime, hua, shpërblime, sponsorizime apo ndihma financiare, të mos reflektohen në analizën financiare dhe, si rrjedhojë, ato nuk mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurive apo mbulimin e shpenzimeve.
205. Sa më sipër është përshkruar dhe arsyetuar, trupi gjykues arrin në përfundimin dhe vlerëson se këto të ardhura, për sa kohë nuk janë provuar as si të përfituara nga subjekti dhe as nga bashkëshorti realisht dhe për shkaqe/arsye dhe mënyra të ligjshme dhe bindëse dhe as lidhur me ligjshmërinë e krijimit të tyre, nuk mund të kenë shërbyer si burim i ligjshëm për krijimin e pasurive apo mbulimin e shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj dhe për rrjedhojë, ato nuk janë përfshirë në analizën financiare.

11. Llogari bankare dyemërore në emër të shtetasve M. Ç. dhe K. Dh.

206. Në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar: *“Depozitë te BKT e hapur nga mamaja e saj M. Ç. bashkë me K. Dh., pa dijeninë e tonë qysh në vitin 2008 dhe ardhur në dijeni të këtij fakti në datën 24.3.2014, shuma 7,046 euro”*. Referuar dokumentacionit bankar konstatohet se në datën 29.2.2008, shtetasja M. Ç. ka hapur një llogari kursimi në emër të saj dhe mbesës K. Dh., në monedhën euro duke depozituar shumën 4,130 euro. Gjatë viteve 2010 dhe 2012 janë kryer tri depozitime të tjera në këtë llogari, konkretisht shumat 436 euro, 520 euro dhe 1,241 euro. Rezulton se në muajt mars dhe maj të vitit 2014 është tërhequr e gjithë vlera e ndodhur në këtë llogari, në shumën 7,339 euro.
207. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se nuk ishte në dijeni të këtij fakti dhe është shprehur se: *“ [] Po si mund të deklaronim diçka për të cilën nuk ishim në dijeni. Për këtë është bërë dhe kallëzim penal, është provuar gjatë hetimit që ne si bashkëshortë nuk kishim asnjë dijeni për këtë depozitë. Banka nuk disponon asnjë autorizim për hapje depozite dhe asnjë certifikatë familjare. Pas kallëzimit penal nëna ime e ka tërhequr shumën e kësaj depozite, nuk i bëmë kallëzim penal BKT-së se nuk besojmë tek drejtësia kur të paditur janë bankat [...]”*.
208. Në përfundim nga sa më sipër, ka rezultuar se nuk është depozituar dokumentacion justifikues ligjor mbi burimin e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, znj. M. Ç., të cilat kanë mundësuar krijimin e kësaj depozite, si dhe nuk është deklaruar mbi destinacionin e kësaj shume pas tërheqjes së saj, duke i kaluar edhe barrën e provës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

209. Në prapësimet e dërguara, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se lidhur me llogarinë bankare dyemërore është sqaruar edhe në prokurori, ku znj. M. Ç. ka depozituar një shumë të hollash në bankë pa qenë në dijeni. Në praktikën e bankës nuk ka asnjë autorizim prej subjektit për fëmijën e mitur, madje paligjshmëria e bankës shkon deri aty sa hap një llogari bankare për

një fëmijë të mitur edhe pa asnjë certifikatë familjare apo të trungut familjar, që të provojë lidhjen e nënës së subjektit me vajzën e saj, K. Dh..

Vlerësimi i trupit gjykues

210. Si përfundim, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk provohet ligjshmëria e burimeve financiare, të cilat kanë shërbyer për krijimin e fondeve në llogarinë bankare dyemërore të konstatuar më sipër.

12. Apartament banimi me sip. 92 m², në G., Kavajë

211. Në DIPP-në e vitit 2018, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi me sip. 92 m², ndodhur në G., Kavajë, ende e paregjistruar në emrin e subjektit dhe të bashkëshortit, si pasuri e fituar me testament nga babai Sh. Ç., kjo e provuar me vendimin për lëshimin e dëshmisë testamentare nr. ***, datë 3.3.2018.

212. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, në pyetjen nr. 4, Komisioni konstaton se subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: “[..] *Lënie me testament për pjesën e vet për një shtëpi banimi ndodhur në G., Kavajë, me burimi krijimit, pasi babai dhe vëllezërit kanë punuar jashtë shtetit në emigracion në Greqi, si dhe kanë ushtruar biznes për vite me radhe te Tregu i Medresesë me shumicë dhe pakicë, si dhe kanë pasur në pronësi hotel bar restorant në P. Pogradec, nga ku kanë nxjerrë të ardhurat përkatëse. Gjithashtu, ai ka ushtruar dhe veprimtarinë e këmbimit valutor për disa vite, i palicencuar, si rezultat i informalitetit që ka ekzistuar në atë kohë [..]*”.

213. Nisur nga sa me sipër, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të depozituar dokumentacion justifikues ligjor të përfitimit të kësaj pasurie.

214. Në prapësimet e dërguara, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e duhur në formën e kërkuar nga ligji në ILDKPKI, së bashku me deklaratën *Vetting*, por nuk ka depozituar dokumentacion ligjor që provon mënyrën e fitimit të pronësisë. Kësisoj subjekti, përpos mosprovueshmërisë së të kundërtës, për sa i ishte kaluar barrë prove, as nuk ka paraqitur shpjegime apo dokumente në Komision, duke konfirmuar mungesën e bashkëpunimit të plotë me këtë institucion, në kundërshtim me dispozitën e nenit 48 të ligjit nr. 84/82016.

13. Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

215. Bazuar në dokumentacionin e administruar⁸³, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, për çdo vit, për periudhën 2004 – 2016, nga ku ka rezultuar një balancë negative në masën 55,521,265 lekë. Për më shumë, referojuni tabelës së analizës financiare (Aneks-1, bashkëlidhur këtij materiali dhe metodologjisë së ndjekur për kryerjen e saj – të pasqyruar në këtë material).

216. Nga sa më lart, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë shpjegimet dhe për të paraqitur dokumentacionin ligjor për të provuar të kundërtën e rezultateve të arritura gjatë hetimit administrativ.

217. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e

⁸³Referuar vendimit të trupit gjykues nr. 2, datë 3.9.2021, janë administruar për t'u bërë pjesë e verifikimit, dokumentacionet e ardhura nga institucionet për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, z. K. Dh.. Gjithashtu, me shkresën nr. *** prot., datë 8.9.2021, ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar për subjektin Klorinda Çela.

shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për çdo vit, për periudhën 2004 – 2016, nga ku ka rezultuar një balancë negative në masën 55,521,265 lekë, duke u gjendur kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

| VITI | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|--|------------------|-------------------|------------------|--------------------|-------------------|--------------------|--------------------|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|--------------------|--------------------|
| A) PASURI | 1,433,139 | 8,437,111 | 272,413 | 560,821 | 460,558 | 30,263,939 | -765,486 | 8,023,222 | 21,094,007 | 222,145 | 1,749,836 | 51,811,470 | -1,421,614 |
| Apartament me sip. 114.6 m2, në Rr. D*** B*** | | 9,142,080 | | | | | | | | | | | |
| Njësi tregtare me sip. 124 m2, në Rr. D*** B*** | | | | | | 30,177,400 | | | | | | | |
| Apartament me sip. 109 m2, në Sh***, Lezhë | | | | | | | | 6,915,000 | | | | | |
| Njësi shërbimi me sipërfaqe 44m2 dhuruar | | | | | | | | | 21,000,000 | | | | |
| Garazh me sip. 18.9 m2 dhe 18.2 m2, në Rr. D*** B*** | | | | | | | | | | | | 1,262,520 | |
| Njësi shërbimi me sip. 46 m2, në Rr. L*** B*** | | | | | | | | | | | | 7,500,000 | |
| Njësi shërbimi me sip. 47 m2, në Rr. D*** B*** | | | | | | | | | | | | 7,500,000 | |
| Njësi shërbimi me sip 47.23m2; 42.62m2; 98.33m2; Rr. D*** B*** | | | | | | | | | | | | 33,920,952 | |
| Ambjent banimi me sip. 51.65 m2, në M*** | | | | | | | | | | | | | |
| Pasuri në proces legalizimi | | | | | | | | | | | | | |
| Automjet Mercedes Benz 250 | | 700,000 | | | | | | | | | | | |
| Automjet Mercedes Benz 220 | | | | | | | | 786,960 | | | | | |
| Ndryshim likuiditeti | 1,433,139 | -1,404,969 | 272,413 | 560,821 | 460,558 | 86,539 | -765,486 | 321,262 | 94,007 | 222,145 | 1,749,836 | 1,627,998 | -1,421,614 |
| B) DETYRIME | 0 | 6,249,540 | 0 | 0 | 0 | 19,203,800 | 10,500,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 41,038,452 | 21,000,000 |
| Kredi për blerje shtëpie Tirana Bank | | 6,249,540 | | | | | | | | | | | |
| Hua nga prindërit | | | | | | | | | | | | 14,000,000 | |
| Kredi tek Raiffeisen Bank (Blerje dyqani) | | | | | | | 10,500,000 | | | | | | |
| Kredi tek OTP Bank (Ish Societe Generale) | | | | | | | | | | | | | 21,000,000 |
| Detyrim ndaj shoqërisë B. R. Shpk. | | | | | | | | | | | | 27,038,452 | |
| Detyrim ndaj shoqërisë S. Shpk. | | | | | | 19,203,800 | | | | | | | |
| C) PASURI NETO (A-B) | 1,433,139 | 2,187,571 | 272,413 | 560,821 | 460,558 | 11,060,139 | -11,265,486 | 8,023,222 | 21,094,007 | 222,145 | 1,749,836 | 10,773,018 | -22,421,614 |
| D) TË ARDHURA | 1,426,559 | 1,647,458 | 1,621,537 | 1,773,300 | 2,426,126 | 2,043,951 | 2,074,772 | 2,698,844 | 22,831,914 | 2,097,835 | 3,862,285 | 3,336,141 | 4,656,906 |
| Të ardhura nga paga SR | 574,822 | 831,911 | 814,861 | 829,691 | 786,926 | 788,146 | 437,715 | 834,439 | 858,197 | 659,390 | 811,820 | 1,072,252 | 1,078,005 |
| Të ardhura nga ISSH SR | | | | | | | | | | | | 392,217 | |
| Të ardhura nga mësimdhënia në U*** K*** SR | | | | 107,300 | 175,748 | 99,619 | | | | | | | |
| Dhurata në formë njësi tregtare nga prindërit | | | | | | | | | 21,000,000 | | | | |
| Të ardhura nga paga e bashkëshortit | 778,600 | 789,078 | 806,676 | 836,309 | 822,412 | 773,326 | 817,877 | 1,003,944 | 946,567 | 882,418 | 1,038,248 | 1,090,889 | 1,071,401 |
| Të ardhura nga mësimdhënia në U*** K*** b/sh | | | | | 641,040 | 382,860 | 819,180 | 858,211 | 27,150 | 556,027 | | | |
| Të ardhura nga mësimdhënia në U*** Q*** b/sh | | | | | | | | 2,250 | | | | | |
| Të ardhura nga qiraja e lokalit në Rr. H. H. D*** | | | | | | | | | | | 1,620,000 | 1,173,000 | 1,759,500 |
| Të ardhura nga qiraja e ambientit për P*** Sh*** | | | | | | | | | | | | | 748,000 |
| Të ardhurat nga interesat e depozitës në Tirana Bank | 73,137 | 26,469 | | | | | | | | | | | |
| E) SHPENZIME | 445,310 | 637,839 | 1,095,382 | 2,699,594 | 3,257,100 | 2,482,499 | 19,585,382 | 2,587,391 | 7,287,197 | 1,678,665 | 3,127,109 | 7,935,871 | 30,599,017 |
| Shpenzime jetike | 369,266 | 328,671 | 328,671 | 369,266 | 409,860 | 409,860 | 409,860 | 409,860 | 423,072 | 521,789 | 879,992 | 897,104 | 940,368 |
| Shpenzime për kredinë pranë Tirana Bank | | 301,203 | 742,589 | 1,930,328 | 2,379,147 | 373,788 | 325,093 | 380,187 | 2,437,835 | | | | |
| Shpenzime për kredinë tek Raiffeisen Bank | | | | | | | 756,646 | 1,538,032 | 3,618,010 | 1,126,030 | 2,186,870 | 5,903,391 | |
| Shpenzime për kredinë tek OTP Bank | | | | | | | | | | | | | 1,155,000 |
| Shpenzime për blerje dyqani 124 m2 | | | | | | | 16,657,200 | | | | | | |
| Shpenzime për blerje dyqanesh (188.18 m2) | | | | | | | | | | | | | 13,527,000 |
| Shpenzime për udhëtime jashtë vendit | 76,044 | 7,965 | 24,122 | 0 | 468,094 | 601,490 | 183,923 | 259,313 | 389,120 | 30,846 | 60,247 | 258,094 | 476,150 |
| Shpenzime shëndetësore jashtë vendit | | | | | | 1,097,360 | 832,860 | 419,160 | | | | | |
| Shpenzime të deklaruara me W*** U*** | | | | | | | 419,800 | | | | | | |
| Shpenzime për shlyerje huaje E. Z. | | | | | | | | | | | | | |
| Shpenzime për shlyerje huaje ndaj Sh. dhe M. Ç. | | | | | | | | | | | | | 14,000,000 |
| Shpenzime për arsimin e vajzës | | | | | | | | | | | | 877,282 | 500,499 |
| Shpenzime mobili apartamenti në Rr. D*** B*** | | | | 400,000 | | | | | | | | | |
| Rezultat i Analizës Financiare (D-C-E) | -451,890 | -1,177,952 | 253,741 | -1,487,115 | -1,291,532 | -11,498,687 | -6,245,124 | -7,911,770 | -5,549,290 | 197,025 | -1,014,661 | -15,372,748 | -3,520,498 |
| CASH në lekë | | | | | | | | | | | 1,400,000 | 1,400,000 | 1,400,000 |
| DIFERENCA E PAMBULUAR | | | | -55,521,265 | | | | | | | | | |

Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

218. Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe në provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (1) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (2) ka kryer fshehje të pasurisë; si dhe (3) ka kryer deklaram të remë, duke u vendosur në kushtet parashikuara në germet “b”, “c”, “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

219. Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

220. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka pasur mungesë të theksuar të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara; (ii) ka kryer në mënyrë të përsëritur

deklarime të pamjaftueshme dhe ka fshehur pasurinë; (iii) kësisoj duke cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

221. Gjithashtu, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioni vlerësoi në tërësi të gjitha konstatimet që lidhen me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se ato janë të tilla që e çojnë këtë trup gjykues në konkluzionin se subjekti me veprimtarinë e saj ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në një mënyrë të pariparueshme nëpërmjet programeve të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës.
222. Nisur nga ky rezultat financiar, trupi gjykues nuk e konsideron të nevojshme analizimin e të gjitha pikave të tjera të rezultateve të hetimit apo kriteret e tjera, pasi referuar problematikave që kanë rezultuar lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme, deklaramet e pasurive të pamjaftueshme dhe duke fshehur pasurinë – rezultatet e njoftuara për të cilat nuk u provua e kundërta mjaftojnë për aplikimin e masës disiplinore, duke i bërë të panevojshme elementet e tjera.
223. Për rrjedhojë, subjekti nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e deklarimit të pasurisë dhe duhet të aplikohet pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjektit të rivlerësimit Klorinda Çela, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duhet t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arrin në përfundimin se:

1. subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë;
3. subjekti nuk është treguar bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ të kryer ndaj saj.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Klorinda Çela, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 28.10.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi